



Vjetari informativ i Departamentit
të Antropologjisë, Fakulteti Filozofik,
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”



Letra e redaksisë

Të dashur lexues,

Me kënaqësi, ju prezantojmë edicionin e pestë të vjetarit nga Departamenti i Antropologjisë në Universitetin e Prishtinës. Ky vëllim synon të pasqyrojë një vit të bujshëm për Departamentin tonë. Mes gjetjeve të mëdha arkeologjike, shkëmbimeve të dijes, hulumtimeve antropologjike, botimeve e konferencave të ndryshme, në këtë vjetar paraqitet puna e madhe e kryer nga stafi akademik dhe studentët e Departamentit. Përgjatë këtij viti akademik, Departamenti arriti të sjellë ekspertë të rinj për të diskutuar tematika të freskëta. Përmes ligjëratave mysafire, kemi pasur mundësinë të thellojmë debate dhe të ofrojmë perspektiva të reja në kuadër të disiplinës sonë. Ky është një shembull i punës sonë për të krijuar një mjedis të frytshëm të mësimin dhe hulumtimit.

Nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të stafit tonë në konferenca dhe seminare të ndryshme, kemi shkëmbyer dije dhe përvoja me kolegët e tjerë nga Kosova dhe bota. Ky dialog i vazhdueshëm ka ndihmuar në arritjen e një perspektive më të gjerë mbi sfidat dhe potencialet e fushës sonë. Botimet e vazhdueshme dhe kontributet e ndryshme të stafit dhe studentëve janë element tjetër që karakterizojnë këtë vit akademik, duke ndihmuar në rritjen e korpusit të dijes në fushën e antropologjisë dhe arkeologjisë. Kjo është një dëshmi e angazhimit tonë për të dokumentuar dhe ndarë me të tjerët gjetjet dhe vëzhgimet tona.

Këtë vit ju njoftojmë se vjetari ynë do të ofrohet edhe në gjuhën angleze. Ky hap i ri do të na mundësojë të ndajmë dijen dhe hulumtimet tona me një audiencë më të gjerë dhe të përcjellim kontributet tona edhe te lexuesit ndërkombëtar. Kjo është një rrugë e re drejt promovimit të dijes antropologjike dhe arkeologjike të Kosovës në nivel global. Përmes punës së përkushtuar dhe pasionit të pashtershëm, Departamenti i Antropologjisë është krenar se ka arritur të avancojë hulumtimin dhe dijen arkeologjike dhe arkeologjike në Kosovë.

Ne vazhdojmë me dëshirë dhe përkushtim të ndikojmë pozitivisht në zhvillimin dhe promovimin e dijes në këto fusha të rëndësishme për kulturën dhe historinë tonë.

Shpresojmë që ky vjetar të shërbejë jo vetëm si një dokumentim i punës sonë për vitin 2023, por edhe si burim frymëzimi për studimet e hulumtime të ardhshme!

Programi i freskuar

Ky vit për Departamentin e Antropologjisë karakterizohet me nisjen e një programi të ri, BA Antropologji dhe Trashëgimi Kulturor. Ky program i freskuar ofron mundësi që studentët të studiojnë antropologjinë si disiplinë unike të studimit të kulturës dhe shoqërisë, duke pasur trashëgiminë kulturore si tematikë kryesore. Programi i ri korrespondon me profilet ndërkombëtare të studimit ku një disiplinë është kryesorja, në kombinim me një disiplinë tjetër apo tematikë specifike. Si rezultat i nevojës së studimit antropologjik të trashëgimisë kulturore, me njohje më të thellë dhe të gjerë empirike, Departamenti ka dizajnuar këtë program specifik për të ju përgjigjur kësaj nevojë.

Me trashëgimi kulturore zakonisht nënkuptohet trashëgimia arkeologjike, arkitekturore, trashëgimia kulturore shpirtërore, peizazhet natyrore, trashëgimia e luajtshme. Prej kështjellave, te muzetë, prej praktikave të vjetra kulturore, te festivalet historike, prej kujtesës kolektive te turizmi kulturor, ekzistojnë një mori aspektesh, temash e kategorish që janë apo ndërliken me trashëgiminë kulturore.

Studentët njihen me qasjet, teoritë, mendimet e metodat antropologjike, por edhe me përdorimin e tyre në studimin e trashëgimisë kulturore, ku përfshihet edhe mënyra se si mbrohet, ruhet e interpretohet trashëgimia kulturore. Risi tjetër e këtij programi është mundësia e studentëve për të ndjekur disa lëndë edhe në gjuhën angleze.

Kosova Anthropologica – revistë e re shkencore e Departamentit

Këtë vit, Departamenti i Antropologjisë ka themeluar edhe revistën e vet *Kosova Anthropologica*. Kjo është një revistë vjetore akademike e Departamentit të Antropologjisë, e cila do të dalë një herë në vit, në dhjetor. Qëllimi i revistës është avancimi i njohurive dhe dijes antropologjike për Kosovën dhe rajonin. Revista shërben si forum i hapur për studiues, kryesisht të fushës së antropologjisë kulturore/sociale, arkeologjisë dhe antropologjisë gjuhësore. I drejtohet audiencës shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të interesuar në studimin antropologjik të kulturës, shoqërisë dhe realiteteve jetësore, me fokus në Kosovë dhe rajon. *Kosova Anthropologica* boton ese në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe angleze. Të gjitha esetë/shkrimet e botuara duhet të jenë të standardeve më të larta të botimit akademik në revista shkencore. *Kosova Anthropologica* është e hapur për kontributet e studiuesve të interesuar për të botuar në fushat/temat e mësipërme dhe përfshin studime të fokusuar në analizë antropologjike, të orientuara nga gjetjet empirike të temave specifike, mirëpo boton edhe ese të cilat janë gjithashtu të orientuara nga reflektimet teorike dhe recensione të librave, filmave, dokumentarëve dhe mediave të tjera vizuale. Numri i parë pritet të publikohet në dhjetor 2023. Për më shumë në shkruani në kosova.anthropologica@uni-pr.edu ose vizitoni [uebfaqen](http://uebfaqja.com).

AA, Nr. 5, tetor 2023

Vjetar informativ i Departamentit të Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".
Redaksia: **Enis Bytyqi**: enis.bytyqi@studenti.uni-pr.edu dhe **Tringa Sefedini**: tringa.sefedini2@studenti.uni-pr.edu
Del njëherë në vit, në formë të shtypur dhe digjitale.
Ballina: © Jeta Veseli

2023 - [uebfaqja](http://uebfaqja.com)

[Uebfaqja e Departamentit të Antropologjisë](http://uebfaqja.com)



Foto nga Terreni,
Kujtesë në gurë: Gdhendja e simboleve në Kulla,
Podujevë, Kosovë

Marrëveshjet e MKRS — Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit

Departamenti i Antropologjisë ka një traditë të mirë të bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Përgjatë viteve MKRS ka përkrahur stafin dhe studentët e Departamentit në fusha të ndryshme, përfshirë edhe projektet e mëdha kulturore dhe punën praktike për studentët e Departamentit, në institucionet e MKRS-së. Së fundi, marrëveshja mes Departamentit dhe MKRS-së është ripërtërirë edhe sivjet.

Në marrëveshjen e nënshkruar me datë 05.04.2023 midis ministrit Hajrullah Çeku dhe Dekanit të Fakultetit Filozofik, Dashmir Bërxulli, janë përfshirë programe studimi, trajnime, seminare, konferenca, projekte, hulumtime dhe kurse të ndryshme praktike të organizuara dhe zhvilluara mes MKRS-së dhe Departamentit të Antropologjisë.

Ky bashkëpunim u mundëson studentëve të Departamentit të Antropologjisë për të kryer punë praktike në fusha të ndryshme, të cilat lidhen me trashëgiminë kulturore, konservimin dhe restaurimin.

Bursat nga MKRS — Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ndan bursa të përvitshme për studentët e antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore. Këtë vit u ndanë 9 bursa nga MKRS për studime në fushat e trashëgimisë kulturore (MA dhe PHD) në universitete të ndryshme evropiane. Shumica prej tyre, ish studentë të Departamentit të Antropologjisë. Deri më tani mbi 30 studentë të Departamentit të Antropologjisë kanë kryer, ose janë në studime postdiplomike jashtë vendit në fushën e antropologjisë, prej arkeologjisë prehistorike deri te antropologjia digjitale. Një numër i madh prej tyre është përkrahur edhe nga MKRS.



Shpërblimet nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës për stafin dhe studentët e Departamentit



Foto nga Universiteti i Prishtinës



Foto nga Universiteti i Prishtinës

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”, me rastin e 78-vjetorit të themelimit, më 22 Nëntor 2022 ka shpërblyer me mirënjohje profesorët e Universitetit të Prishtinës, Prof. Asoc. Dr. Arsim Canolli, Prof. Ass. Dr. Shemsi Krasniqi dhe Prof. Ass. Dr. Tahir Latifi, për punën e bërë si mentorë të projektit “Kujtesa e Kosovës: Rrëfimet e të mbijetuarve të masakrës së Krushës së Madhe”. Mirënjohjet janë ndarë nga rektori i UP-së, Prof. Dr. Qerim Qerimi.

Projekti, i cili tani është në fazën finale të realizimit, synon të dokumentojë, publikojë dhe të ruajë rrëfimet e të mbijetuarve dhe dëshmitarëve okularë të masakrës së Krushës së Madhe të Komunës së Rahovecit në Kosovë. I njëjti është rezultat i bashkëpunimit mes Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komunës së Rahovecit dhe Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Kontribut të rëndësishëm në këtë projekt kanë dhënë edhe 35 studentë dhe të diplomuar të UP-së të fushës së antropologjisë kulturore, sociologjisë, historisë, gazetarisë, si dhe fushave të tjera të përafërta, të cilët kanë realizuar mbi 200 intervista në terren.

Doracaku

Një nga atributet më të veçuara të Departamentit të Antropologjisë është transparenca e stafit akademik ndaj studentëve të tyre. Kjo më së miri kuptohet përmes doracakut të përvjetshëm, që përgatitet nga vetë Departamenti.

Doracaku i Departamentit të Antropologjisë shërben si një udhëzues për çdo paqartësi apo kureshtje të studentëve. Këshillohet që, para fillimit semestral të lexohet doracaku, kjo mund të bëhet edhe gjatë gjithë vitit të studimeve.

Për këtë arsye, ky udhëzues është shumë i qartë dhe lehtë i lexueshëm. Aty mund të gjeni këshilla, programin mësimor, për shkrimin antropologjik (si përdoren referencat, citimet etj.), informacion për mësimdhënësit e rregullt dhe të angazhuar, informacion për aktivitetet e synuara dhe gjithçka në lidhje me përkrahjen që jepet për studentë.



→ Lexoni më shumë në [Doracakun për studentë](#)

Info dhe *Aktivitetete*

Tryeza e Departamentit të Antropologjisë

*“Ne me të tjerët: Hulumtime, projekte,
prezantime të Departamentit të
Antropologjisë dhe partnerëve”*

Departamenti i Antropologjisë gjithmonë ka bashkëpunuar me partnerë të shumtë si: Universitete të ndryshme ndërkombëtare, institucione të trashëgimisë kulturore të nivelit lokal e qendror, organizata joqeveritare, departamente të kulturës në nivelin komunal, media etj. Këto bashkëpunime jo vetëm që i kanë ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre për hulumtim, e analizë, por edhe kanë sjellë produkte të ndryshme si botime, ekspozita, video incizime. Këto materiale mund të shërbejnë jo vetëm për studentë të Departamentit të Antropologjisë por edhe studentëve të drejtimeve tjera, si dhe shoqërisë në përgjithësi.

Pra, bashkëpunimet u ndihmojnë studentëve të punojnë në ekipe, të marrin përgjegjësi, të vlerësojnë mendimet e të tjerëve dhe të njohin kontributin e të gjithë pjesëtarëve të përfshirë në projekt.

Në tryezën e Departamentit të Antropologjisë të mbajtur më 19 Prill të vitit 2023 të përbërë nga 6 panele (me 20 prezantues) janë prezantuar projekte të Departamentit nga perspektiva e profesorit, studentit si dhe bashkëpunëtorit, qoftë nga universitete ndërkombëtare, organizatë joqeveritare, komunitet etj. Temat kanë qenë shumë të larmishme, duke ofruar edhe metodologji të ndryshme të hulumtimit dhe projekte mjaft me interes për vendin. Po ashtu, diskutimi ka qenë i frytshëm me shumë pyetje e komente për të gjithë panelistët.

- Zanita Halimi



Foto nga Tryeza e Departamentit

Kongresi ndërkombëtar për arkeologjinë e Ballkanit



Foto nga Epoka e Re

Më 17-19 Nëntor 2022 në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë u mbajt konferenca ndërkombëtare "Arkeologjia e Ballkanit nga parahistoria deri në fund të antikitetit: Zbulimet e fundit dhe metodat e reja". Konferenca u mbajt për herë të parë në Kosovë, studiues të ndryshëm nga Ballkani dhe më gjerë synonin që projektet e tyre t'i ndajnë me të tjerët, si dhe të prezantojnë të rejtat e fundit në fushën e arkeologjisë dhe qasjet e reja metodologjike.

Në hapjen e kësaj konference kanë marrë pjesë përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", profesorë dhe ekspertë të arkeologjisë nga Anglia, SHBA, Shqipëria, Italia, Franca, etj. Studiuesi francez, Christophe Goddard, i pranishëm në hapje, u shpreh se trashëgimia mund të mbetet vetëm nëse është e mirëmbajtur dhe duhet ndihmë që të realizohet kjo mirëmbajtje. "Nuk ka

arkeologji pa trajnime, mu për këtë i gjithë qëllimi i universiteteve tona kudo që jemi është qenësore që jo vetëm të ndërtojmë një arkeologji të mirëfilltë shkencore por po ashtu të krijojmë këtë gjeneratë të re të specialistëve që duhet të punojnë bashkërisht", u shpreh Goddard duke falënderuar më tutje organizatorët e kësaj konference.

Programi

17 Nëntor 2022

PARAHISTORIA DHE PROTOHISTORIA

Drejtues seance: Hrvoje
Potrebica

10:40 - 11:00: **Të dhëna kronologjike dhe kulturore mbi procesin e neolitizimit në Shqipëri**
Ilir Gjipali (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)
Edlira Andoni (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)

11:10 - 11:20: **Të dhëna të reja për qytetërimin e epokës së bronzit në Kosovë**
Adem Bunguri (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)

11:20 - 11:40: **Kërkime arkeologjike nënujore në liqenin e Ohrit dhe të Prespës – Një lidhje e mundshme ndërmjet Lin 3 dhe sitit Dunavec**
Adrian Anastasi (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)

11:40 - 12:00: **Arkeologjia rajonale në rrethin e Pejës dhe Istogut të Kosovës (RAPID-K), 2018 -**

2021 – **Rezultatet preliminare**

Michael L. Galaty (Universiteti i Michiganit)
Haxhi Mehmetaj (Instituti i Arkeologjisë, Prishtinë)
Sylvia Deskaj (Universiteti i Michiganit)

12:00 - 12:20: **Vendbanimi parahistorik i Dobratinit**
Shafi Gashi (Instituti Arkeologjik i Kosovës)
Berat Ademi (Instituti Albanologjik i Kosovës)

12:20 - 12:40: **Periudha e bronzit të vonë, gjetjet arkeologjike nga Kalaja e Dardanës**
Klodian Velo (arkeolog, Shqipëri)
Shafi Gashi (Instituti Arkeologjik i Kosovës)

RITUALET FUNERALE DHE KULTURA ARISTOKRATE

Drejtues seance: Stéphane
Verger

14:20 - 14:40: **Shfaqja e krerëve të epokës së hershme të hekurit në Ballkan**
Hrvoje Potrebica (Universiteti i Zagrebit)

14:40 - 15:00: **Varret e gdhendura në shkëmb të luginës së lumit Mat në Shqipëri – Rezultatet paraprake nga sezoni fushor 2022**
Olsa Lafe (Universiteti i Aleksandër Moisiu, Durrës)
Romir Mazari (Arkitekt - restauror, Shqipëri)
Gjergj Gjuraç (Arkeolog, Shqipëri)
Berbis Islami (Instituti Kombëtar për Trashëgimi Kulturor, Shqipëri)
Albana Stefa (Instituti Kombëtar për Trashëgimi Kulturor, Shqipëri)

15:00 - 15:20: **Nekropoli tumular i Dollcit**
Premtim Alaj (Instituti i Arkeologjisë, Prishtinë)
Sedat Baraliu (Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina")

15:20 - 15:40: **Grup varresh me arkitekturë të thjeshtë dhe monumentale në nekropolon verilindor të Amantias – Aspekte të arkitekturës, riteve të varrimit dhe objekteve të inventarit**
Kriledjan Çipa (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)
Mariglen Memushi (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)
Ulsi Toti (Universiteti d'Avignon)

EKONOMIA DHE SHKËMBIMET KULTURORE

Drejtues seance: Albena
Milanova

16: 20 - 16:40: **Nyja Messapic – Sfida e segmentimit dhe interpretimit të Scriptio Continua**
Kujtim Mani (Instituti i Albanologjisë, Prishtinë)

16:40 - 17:00: **Depozita e bitumit Nymphaion – Gjeografia historike dhe arkeologjia**
Francois Quantin (École Pratique des Hautes Études/IRAA UMR 6222 CNRS)
Saimir Shpuza (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)

17:00 - 17:20: **Limes Vanonis – Një mbishkrim romak i pabotuar nga Rahoveci (Kosovë)**
Emine Kalaja (Instituti i Historisë, Prishtinë)
Ilir Culaj (Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina")

Programi

18 Nëntor 2022

QYTETET HELENISTIKE DHE ROMAKE

Drejtues seance: Balisa Muka

9:30 - 9:50: **Dardania e shek. V - I p.kr. Midis fragmentarizimit historik dhe realitetit arkeologjik**
Neritan Ceka (Arkeolog, Shqipëri)

9:50 - 10:10: **Arkitektura dhe urbanistika në Orikos gjatë periudhës helenistike**
Saimir Shpuza (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)
Gionata Consagra (Universiteti i Gjenezës)

10:10 - 10:30: **Apollonia-d'Illyrie – portreti i një**



Foto nga MKRS

qyteti afatgjatë

Stéphane verger (Muzeu Kombëtar Romak, Romë)

10:30 - 10:50: **Një dritë e re në Kaoninë Bregdetare – Kërkime arkeologjike shqiptaro-italiane në Phoinike dhe Butrint**

Belisa Muka (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)

G. Lepore (Universiteti i Bolonjës)

E. Giorgi (Universiteti i Bolonjës)

10:50 - 11:10: **Beteja e Aoi Stenës (198 p.e.s) dhe gjurmët e fortifikimeve në territor**

Taulant Rama (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)

Eduard Shehi (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)

QYTETET E ANTIKITETIT TË VONË

Drejtues seance: Luan Përzhita

11:50 - 12:10: **Durrësi antik i vonë në dritën e dëshmimeve të reja arkeologjike**

Brikena Shkodra-Rrugia (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)

12:10 - 12:30: **Nga Ulpiana në Justiniana Secunda**

Christophe J. Goddard (CNRS-ENS, AOROC, Paris)

Arben Hajdari (Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”)

Milot Berisha (Instituti i Arkeologjisë, Prishtinë)

Marco Maiuro (Universiteti La Sapienza, Romë)

12:30 - 12:50: **Pallati Perandorak dhe qyteti Sirmium**

Richard Miles (Universiteti i Sydney)

FORTIFIKIMI DHE PEIZAZHET E ANTIKITETIT TË VONË

Drejtues seance: Richard Miles

13:40 - 14:00: **Puna e fundit në terren e projektit**

ndërkombëtar arkeologjik në Zaldapa, Bullgari

Albena Milanova (Universiteti i Sofjes “Kliment Ohridski”)

Nicolas Beaudry (Universiteti i Québec à Rimouski, Kanadë)

Georgi Atanasov (Muzeu Historik Regjional - Silistra, Bullgari)

Dominic Moreau (Universiteti Lille, Francë)

14:00 - 14:20: **Rajoni i Drinit të Zi në periudhën antike të vonë**

Luan Përzhita (Akademia e Studimeve

Albanologjike, Tiranë)

14:20 - 14:40: **Peizazhet e fortifikuara në Shqipërinë qendrore dhe juglindore – Një projekt kërkimi dhe studimi**

Altin Skenderaj (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)

Luigi Maria Calio (Universiteti i Catanias)

14:40 - 15:00: **Rreth një episodi historik dhe arkeologjik nga mesi i shek. VI në krahinat e Praevalis dhe Dardanisë**

Gëzim Hoxha (Instituti i Arkeologjisë, Tiranë)

15:30 - 16:20: **Konkluzionet e përgjithshme**

Elisabeth Fentress

Programi

19 Nëntor 2022

Vizitat pas përmbylljes së konferencës

Parku Arkeologjik “Ulpiana”

Manastiri i Graçanicës

Kalaja e Prizrenit

Suksesi i kësaj konference të parë arkeologjike ndërkombëtare në Kosovë, ka vendosur themele të qëndrueshme për nismat e ardhshme në këtë fushë. Ajo tregon potencialin për rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm në hulumtimin arkeologjik, ruajtjen dhe edukimin arkeologjik brenda Kosovës dhe përtej saj. Ndërsa reflektojmë mbi këtë ngjarje të rëndësishme, na kujton rëndësinë e vazhdueshme të arkeologjisë në zbulimin e historisë së përbashkët të njerëzimit dhe në promovimin e vlerësimit dhe bashkëpunimit kulturor në shkallë globale.

Të drejtat e fisit sámii në Norvegji - ligjëratë e Prof. Stener Ekern

Profesori Stener Ekern, antropolog nga Qendra Norvegjeze për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Oslos, më 11.05.2023, mbajti një ligjëratë me studentët e antropologjisë mbi “Të drejtat e fisit sámii në Norvegji”. Profesor Ekern ishte në Kosovë përmes programit të shkëmbimit ERASMUS+, që Universiteti i Prishtinës ka me një mori universitetesh në Evropë. Profesor Ekern theksoi se, për herë të parë ka qenë në Kosovë vitin 1973, por si turist, në jug të Jugosllavisë së atëherëshme.

Në ligjëratën para studentëve, ai ofroi një pamje të historisë së të drejtave të fisit sámii, fis indigjen në Norvegji, porqështrihet edhe në shtetet tjera nordike dhe Rusi. Sámi janë një fis, një popull, por kanë 10 dialekte goxha të ndryshme, që fliten në Fenoskandinavi. Ata kanë një prezencë të vazhdueshme në ato vise, të paktën prej 12 mijë vite më parë. Pa dyshim se shquhen për praktikat e ndryshme të gjahut të drerit, por sámii jetojnë sot të mishëruar në shoqërinë norvegjeze. Prej vitit 1987 njihen si popull indigjen atje dhe kanë forma të ndryshme të vetë-identifikimit. Për 100 vite, 1860-1960, gjatë kombformimit norvegjez ata ishin po ashtu të privuar nga disa të drejta, por në gjysmën e dytë të shekullit 20, fitojnë një status të ri brenda shtetit-komb të Norvegjisë, duke pasur edhe parlamentin e tyre.

Profesor Ekern diskutoi për mënyrën se si ligjet ndërkombëtare e bëjnë objekt të tyre kulturën mbi baza materiale, ku, për shembull, kopeizmi i drerëve të egër, një traditë e lashtë sámii, bëhet baza kryesore e asaj që mbrohet me të drejtën ndërkombëtare. Pra, kërkohet një objektivim kulturor që mund të shënjohej si kulturë dhe të mbrohet. Nga ana tjetër, vetëm 10% e popullsisë sámii merren me kopeizmin e drerëve, të tjerët punojnë sikurse norvegjezët në sfera të tjera të shoqërisë.

Pyetja shtrohet: çfarë është kultura sámii? Një grusht shenjash apo praktikash të ekzotizuara dhe fiksuara nga nacionalizimi në një anë dhe e drejta ndërkombëtare në anën tjetër? Apo jeta e përditshme e 90% të popullsisë sámii që nuk merret me këtë punë? Pse ekziston një gjakim për të identifikuar “survivancat” për vetë-identifikim? Si punon vetë-identifikimi në kontekst të së drejtës ndërkombëtare, por edhe të diferencimit brenda shtetit-komb?

Përmes shembullit të të drejtave indigjene të fisit sámii në Norvegji, Profesor Ekern hapi një diskutim për të drejtën indigjene në përgjithësi, raportet e minoriteteve në kontekst të shtetit-komb, nacionalizmin e identitetin grupor, në kohën e ndryshimeve të mëdha në ekologji, teknologji dhe kulturë të vetë-identifikimit politik.

Studimet për kulturën dhe shoqëritë shqiptare në Universitetin e Regensburgut - ligjëratat e Prof. Ger Duijzings

Studimet shqiptare janë kthyer në qendër të studimeve rajonale në Regensburg, Gjermani, falë projektit “A small but fertile field: Strengthening Southeast European Studies in Regensburg” (Një fushë e vogël, por e frytshme: Fuqizimi i Studimeve të Evropës Juglindore në Regensburg), projekt ky i Universitetit të Prishtinës, në partneritet me Universitetin e Regensburgut. Pjesa më dinamike e këtij projekti i dedikohet studimeve shqiptare, ku shqipja do të jetë gjuhë që mësohet në Universitetin e Regensburgut, do të ketë vizita të profesorëve lokalë atje, të atyre këtu, fonde për doktoratë në fushën e antropologjisë, historisë dhe gjuhësisë së viseve shqiptare dhe gjithë rajonit, fonde për hulumtime, studime postdoktorale e shumë risi të tjera. Po ashtu, Universiteti i Prishtinës dhe Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit në Tiranë, janë partnerët kyç në këtë përpjekje për të rivitalizuar studimet shqiptare në një qendër universitare gjermane si është Regensburgu, ku është njëra ndër qendrat më të mëdha të studimeve mbi Evropën Juglindore.

Duhet theksuar se studimet shqiptare kanë filluar

të dalin në hartën e studimeve evropiane dhe ky projekt është një prej hallkave të rëndësishme për të kthyer vëmendjen kah Kosova, Shqipëria e rajoni. Gjatë vizitës së tij në Kosovë, profesori Duijzings, ndër të tjera, ka organizuar edhe ligjëratë para stafit dhe studentëve të UP-së, e cila u mbajt me datë 22 shkurt 2023, me temën “Nëse makinat mund të ecin: rrugët postsocialiste mes qarkullimit dhe miqësisë”. Në këtë ligjëratë, Ger Duijzings paraqiti disa nga idetë kryesore të një vëllimi të ri të redaktuar me gjeografin Tauri Tuvikene (Universiteti i Talinit) mbi jetën e rrugës në qytetet postsocialiste. Pika fillestare është shpërthimi i lëvizshmërisë së makinave private nga vitet 1990 e tutje, me raste studimi që dokumentojnë tensionet midis ‘lëvizshmërisë’ dhe ‘shoqërueshmërisë’ në qytete si Bukureshti dhe Prishtina. Biseda reflektoi mbi atë se çfarë ka nënkuptuar ky ‘pushtim i makinave’ për strukturën urbane të qyteteve - me kërkesat për fluks të papenguar të automjeteve që janë në konflikt me nevojën për banim dhe komoditet dhe shoqërueshmëri me ritëm të ngadaltë për këmbësorët. Ligjërata gjithashtu trajtoi rëndësinë e definimit të këtyre rrugëve si “pas-socialiste”, duke parë rrugët historike që lidhin fenomenet aktuale me të kaluarën socialiste dhe duke nxjerrë në pah dallimet me të ashtuquajturin “perëndim”, i cili ka formësuar modelet e fundit të lëvizshmërisë.]]]]

Profesor Tahir Latifi studion migrimin kosovar në Vjenë

Në verën e vitit 2023, Tahir Latifi qëndroi në Vjenë, Austri, ku bashkëpunoi me profesor Robert Pichler për të vazhduar studimin e tij mbi eksodin kosovar të vitit 2014-2015.

Një nga çështjet e diskutuara të këtij studimi është se, a ishte ky migrim i parregullt një eksod apo jo. Mirëpo, duke i trajtuar fljalorët enciklopedik dhe studime tjera në shkenca sociale dhe, marrë parasysh se, për një kohë më shumë se 3 muajsh, rreth 100.000 persona vendosen të largohen nga

vendi i tyre, nga një shtet me popullsi prej rreth 1.5 - 1.6mil. banorë.

Ky cilësohet një numër i madh i personave që vendosin të migrojnë në një kohë aq të shkurtër. Rezultati i këtij fenomeni definon një formë të tillë të migrimit (eksodin) edhe nëse nuk është i dhunshëm. Kështu që, ky eksod ose vetë-eksod vjen nga disa faktorë të brendshëm, si rezultat i akumulimit të pakënaqësisë ndaj situatës politike, shoqërore dhe ekonomike.

Kur studiohet mbi raste të tilla, duhet trajtuar dhe terminologjia e duhur. Në parim, secila qenie njerëzore ka të dretjën e lëvizjes dhe, po ashtu, të kërkojë një mirëqenie më stabile kudo, nga vendi përkatës. Për këtë arsye termi “migrim ilegal” duket paksa si i vrazhdë. Mirëpo, me të drejtë është të quhet migrim i parregullt, për arsye se këta persona morrën rrugën nga Kosova për të shkuar në Serbi, e më tutje në zonën Shengen, gjegjësisht në zonën kufitare të Hungarisë, për të vazhduar pastaj në shtete të ndryshme të Evropës Perëndimore. Ky rrugëtim kryej pa viza, pa leje pune dhe pa dokumente të duhura.

Tahir Latifi ka konsideruar se ky fenomen duhet të studiohet nga perspektiva antropologjike. Në të kaluarën ka pasur studime dhe raporte për eksodin kosovar të vitit 2014-2015, mirëpo është e rëndësishme të kuptohet kjo, se ende edhe sot ka paqartësi se përse në të vërtetë filluan të largoheshin njerëzit nga Kosova gjatë atyre viteve. Sfidat e kësaj është se tashmë ka kaluar një kohë 8 vjeçare prej se kjo ka ndodhur, dhe zbehja e aktualitetit të ngjarjes e ndikon studimin për të. Po ashtu, dalin probleme edhe me qartësinë e statusit të refugjatit, sepse në të vërtetë, këta persona në vendet evropiane nuk konsideroheshin si refugjatë. Në anën tjetër, gjatë viteve 2014/2015, nuk parashihej ndonjë rrezik politik për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, rrjedhimisht as e drejta për azil politik nuk njihej nga shtete të ndryshme në Evropën Perëndimore.

Ndër sfidat kryesore të studimit është ngurrimi i subjekteve për të treguar narrativat e tyre. Vështirësia e artikullimit të ndjenjave të tyre paraqet një ngecje në kuptimin e arsyeve reale të marrjes së vendimit për t’u larguar nga shteti përmes migrimit të parregullt. Çfarë vërehet nga analizimi i raporteve dhe mediave ndërkombëtare është “ikja nga vendi i pashpresë”. Mungesa e shpresës për një jetë më të mirë në

Kosovë, mund të jetë njëri ndër faktorët që ka nxitur këtë lloj migrimi. Nga qershori deri në fund të vitit 2014, në Kosovë kishte një “ngërç politik”. Për rreth 6 muaj gjendja politike ishte e paqartë, e kjo rezultoi në tensione dhe pasiguri mes popullit. Akumulimi i pakënaqësisë ishte shkaku që u ndërmorën vendime të tilla. Gjatë analizimit të raporteve dhe mediave kuptohet se, këta persona në të shumtën e rasteve as nuk kishin një destinacion të caktuar. Në raste të pyetjes se ku do të shkonin i’u përgjigjeshin me “kudo, nuk ka rëndësi se ku, kudo, sepse në Kosovë s’ka më jetë”. Nga kjo, pjesërisht kuptohet se situata politike dhe gjendja ekonomike në Kosovë, i ka bërë njerëzit të mendojnë dhe veprojnë ashtu. Ndikim të madh në rritjen e intensitetit të ikjes e kishin edhe mediat. Në kohën kur lajmi përhapet shumë shpejtë, njëkohësisht edhe ndikon në masën e gjerë. Mediat në Kosovë, në mënyrë indirekte, kanë luajtur rol në nxitjen e njerëzve për tu larguar nga vendi tyre. Në lajmet e medias, përveç se është treguar numri i rasteve të migrimit, njëkohësisht është treguar edhe

kostoja dhe itinerari udhëtimeve nga Kosova në Hungari.

Pa marrë parasysh këto supozime, këto hipoteza, konsiderohet se duhet edhe më shumë kohë për të arritur në përfundime më konkrete mbi paqartësitë e eksodit të 2014-2015-tës. Nuk mund të konkludohet apo të paragjykohej rezultati ende pa përfunduar metodat kërkimore të studimit, të cilat përmbledhin analiza të raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, mediave, vendimeve dhe deklarimeve të personave që e jetuan këtë realitet, të aktiviteteve dhe veprimeve të qeverisë së Kosovës dhe nga vendet pritëse, si dhe intervistave të thella me subjekte të përfshirë në këtë eksod.

Profesor Tahir Latifi është në kërkim të një arsyeje/ apo disa arsyeve të mëdha, për të dhënë një kuptim më holistik të të gjithë situatës. Studimi tij është duke vazhduar ende dhe, duhet punuar tutje që rezultati i një studimi kaq të ndjeshëm të përkojë me të vërtetën reale.



Profesori Stener Ekern para studentëve të antropologjisë

MEMORIALI PËR FËMIJËT E VRARË DHE TË ZHDUKUR GJATË LUFTËS 1998-1999 NË KOSOVË

PËR TË QENË PJESË E KONSULTIMEVE
MBI PROJEKTIN, KONTAKTONI NË:

046/222-006 APO
MEMORIALI@RKS-GOV.NET

Departamenti i Antropologjisë realizon edhe dy projekte nacionale për trashëgiminë e luftës në Kosovë



Foto nga Durim Abdullahu

Në harkun kohor mes vitit 2022 dhe 2023, Departamenti i Antropologjisë i Universitetit të Prishtinës, është përfshirë edhe në dy projekte të reja të përmasave nacionale për historinë dhe trashëgiminë e luftës në Kosovë. Në mars të vitit 2022, anëtari i stafit akademik të Fakultetit Filozofik, Asistent Durim Abdullahu, në cilësinë e historianit, u zgjodh anëtar në Komisionin e Ekspertëve, i emëruar nga Komiteti Ndërmintor në projektin për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz. Projekti është nisur nga Qeveria e Kosovës dhe drejtuar nga Zyra e Kryeministrit. Detyra e tij ishte të hulumtonte historinë e familjes Jashari, nga gjenealogjia të përfshirja e kësaj familje në lëvizjen e rezistencës së armatosur dhe, nga aksionet policore serbe kundër saj deri te rënia e familjes Jashari në mars të vitit 1998, në luftë me forcat e armatosura serbe. Për realizimin e kësaj detyre, kërkohet konsultimi i gjithë literaturës dhe materialeve audiovizuale të prodhuara deri sot për këtë histori, si dhe të intervistoheshin disa nga personat e përfshirë në ngjarjet e kohës, akterë dhe dëshmitarë. Në këtë projekt, ishin të përfshirë edhe dy studentë nga Departamenti i Antropologjisë, Labeat Elshani dhe Valentina Krasniqi, të cilët bënë etnografi në terren për nevojat e këtij projekti. Faza e parë e këtij projekti, u shtri nga marsi deri në dhjetor të vitit 2022.

Në prill të vitit 2023, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës e nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës, për një projekt tjetër të veçantë për trashëgiminë e luftës. Fjala është për një projekt të fokusuar te konsultimi i familjarëve për memorializimin e fëmijëve të vrarë, të zhdukur apo të vdekur gjatë luftës në Kosovë më 1998 – 1999. Për realizimin e kësaj faze konsultative dhe dokumentuese, u angazhua Asistenti Durim Abdullahu nga Departamenti i Antropologjisë dhe Asistenti Erëblir Kadriu nga Departamenti i Psikologjisë. Nevojat e këtij projekti, kërkonin përfshirjen e studentëve që do t'i realizonin intervistat në terren, rreth 200 sosh sa ishin paraparë. Kështu nga një konkurs, u përzgjedhën 20 studentë nga departamente të ndryshme të Fakultetit Filozofik, mes të cilëve nga Departamenti i Antropologjisë, u përfshinë në projekt këta studentë: Labeat Elshani, Valentina Krasniqi, Arbësa Berisha dhe Fatjona Berisha. Pas një trajnimit tre ditor, studentët nisën punën e tyre në terren për realizimin e intervistave, të mentoruar nga dy drejtuesit e kësaj faze të këtij projekti, asistentët Durim Abdullahu dhe Erëblir Kadriu. Ky projekt po vazhdon ende, me synim konsultimin e familjarëve dhe dëshmitarëve të atyre rreth 1200 (?) viktimave të luftës në Kosovë, që kur u vranë apo e humbën jetën ishin nën moshën 18 vjeçare.

- Durim Abdullahu


Projekti inovativ i studentëve në fushën e trashëgimisë kulturore digjitale

Enis Bytyqi dhe Tringa Sefedini, studentë të Departamentit të Antropologjisë, kanë fituar një grant nga UNDP-Kosova me mbështetjen e projektit “Trashëgimia kulturore si nxitëse për dialogun ndërkomunitar dhe kohezionin social”, i financuar nga Bashkimi Evropian në Kosovë. Ata kanë ndërmarrë një hap të rëndësishëm në digjitalizimin e arkivit të festivalit “Akordet e Kosovës”. Kjo përpjekje dokumenton trashëgiminë jo materiale të Kosovës përmes teknologjisë digjitale, duke e bërë atë të lehtë për t’u qasur nga muzikantët, hulumtuesit, admiruesit e kulturës dhe muzikës në veçanti.

Me një qasje inovative, këta dy studentë kanë shndërruar trashëgiminë jo materiale të Kosovës në një përvojë të qasshme dhe interaktive për të gjithë ata që duan të eksplorojnë muzikën dhe historinë e këtij vendi. Duke ndjekur metodat antropologjike të hulumtimit, ata kanë krijuar një platformë online e cila sjell në jetë kujtimet e festivalit “Akordet e Kosovës” dhe krijimtarinë artistike të shekullit të kaluar në Kosovë. Aty, mund të gjeni historikun e kësaj ngjarjeje kulturore, përmbajtje nga netët e festivalit, këngë, fotografi, video, shpërblimet, librat e festivalit si dhe shumëçka tjetër.

Projekti shërben gjithashtu si një model i mirë për praktikën e reja të promovimit të trashëgimisë kulturore. Ai i kontribuon hulumtimit të trashëgimisë jo materiale të Kosovës dhe e sjell këtë çështje në vëmendjen e publikut. Për të mësuar më shumë dhe për të eksploruar këtë rrugëtim nëpër kohë, ju ftojmë të vizitoni uebfaqen e tyre, të cilën mund ta gjeni në

festakordet.com



Enis Bytyqi dhe Tringa Sefedini në promovimin e projektit, Prishtinë

Java e Filmit Etnografik



Tesa Kabashi në eventin
"Java e Filmit Etnografik", kino Armata, Prishtinë



Rozafa Berisha në eventin
"Java e Filmit Etnografik", kino Armata, Prishtinë



Foto nga eventin "Java e Filmit Etnografik"

Në një përpjekje për të eksploruar dhe promovuar zhanrin e filmit etnografik, Departamenti i Antropologjisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës ka organizuar me sukses "Javën e Filmit Etnografik". Kjo ngjarje është një iniciativë e re e studentes së Departamentit tonë Tesa Kabashi, e cila ka bashkëorganizuar eventin me Rozafa Berishën (ligjëruese në Departamentin e Antropologjisë) dhe Ismail Myrselin (ish-student i arkeologjisë) në bashkëpunim me Kino ARMATA.

Filmi etnografik është një mjet i rëndësishëm për të dokumentuar dhe përshkruar kulturat dhe traditat e ndryshme njerëzore. Përmes imazheve dhe historive, ky lloj filmi na jep një perspektivë të ngjashme me studimet antropologjike, por në një format më të qasshëm dhe të kuptueshëm për një publik më të gjerë.

Përgjatë datave 12,13 dhe 14 qershor 2023, u shfaqën tre filma etnografik. Duke filluar me "Chronicle of a summer" (Kronikë e një vere), një film dokumentar i vitit 1965 nga regjisorët Jean Rouch dhe Edgar Morin. Ky film është një eksperiment i ndryshëm nga të tjerët i kohës së tij, pasi përdor teknika të ndryshme, duke përfshirë intervistat e njerëzve të zakonshëm për të shpalosur thellësinë e ndjenjave dhe ndryshimeve shoqërore në Parisin e vitit 1960. Filmi i dytë, i cili u shfaq në këtë ngjarje, ishte "Unity Through Culture" (Bashkimi përmes kulturës) nga Christian Suhr dhe Ton Otto. Filmi paraqet përpjekjet e vendasve në ishullin Baluan (Papua Guinea e Re) për të (ri)definuar kulturën, traditën, dhe identitetin. Përmes ritmeve muzikore dhe pamjeve mbresëlënëse filmi thërret të reflektojmë mbi transformimet shoqërore në kontekstet post-koloniale dhe efektin e globalizimit.

Ndërsa në mbrëmjen e fundit, u shfaq filmi "About love on a small island" (Për dashurinë në një ishull të vogël). Filmi vë në pikëpyetje përfaqësimet stereotipike të grave myslimane dhe hap pas hapi, zbulon kompleksitetin e martesës dhe shumëllojshmërinë e ideve për dashurinë ideale dhe seksualitetin. Në fund, pjesëmarrësit patën mundësinë të marrin pjesë në një diskutim virtual me regjisorin e këtij filmi Elaheh Habibi.

Java e Filmit Etnografik do të vazhdojë me edicionin e dytë në Qershor 2024.



Foto nga eventin "Java e Filmit Etnografik"

Ditari Arkeologjik

“Nuk është e lehtë t’i bësh gurët të flasin”

– Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari

Gërmimet në Ulpianë dhe zbulimi i ri

Më 3 gusht, 2023, vizituam grupin e gërmuesëve në një zonë 700 metra larg qytetit antik të Ulpianës, për të bërë pak etnografi në një lokalitet arkeologjik, pa e ditur se disa ditë më vonë, ky projekt gërmimi, do të pasurohej edhe me zbulimin e një mbishkrimi të ri të Perandorit Justinian, si një përkushtim për vendin e tij të origjinës.



Mozaiiku i zbuluar në Ulpianë, Kosovë

Projekti udhëhiqet dhe realizohet nga Christophe Goddard, Arben Hajdari dhe Milot Berisha, ku marrin pjesë studentë të Departamentit të Arkeologjisë dhe studentë nga grupi francez. Atyre në ndihmë ju vinin edhe banorë të zonës përreth lokalitetit, e të gjithë bashkë punonin nën diellin përvëlues të gushtit. Shtresë për shtresë, duke hequr pluhurin dhe baltën shekullore, ata u gjendën para strukturave të reja dhe të një mozaiku të pa zbuluar më parë.

Puna bashkëpunuese dhe vendosmëria e gërmuesve jepte një ndjenjë përgjegjësie dhe etjeje për lashtësinë. Përmasat e Bazilikës së zbuluar janë 75 metra gjatësi dhe 24 metra gjerësi, e gjithë dyshemeja e neftit qendror ishte e mbuluar me mozaik katërngjyrësh polikrom, të zbuluar me ornamente gjeometrike të valëzuara.

Rëndësia e këtij zbulimi ka peshë të madhe historike. Sipas Ilir Culaj “mozaiku i gjetur është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse tregon se Dardania po vazhdon të përmendet në shek.VI p.e.r. dhe përmendet në kontekst të një qyteti, ku perandori Justiniani i Madh dhe perandorja Teodora urdhërojnë një numër të madh të ndërtimeve, vetë themelimin e qytetit”.

Dihet se, në vitin 518, Ulpianën antike e godet një termet i rëndë, dhe mbishkrimi i gjetur dëshmon në rindërtimin e qytetit nga Perandori Justiniani i Madh dhe emërimin e tij në 'Justiniana Secunda'. Mbi të gjitha, ky zbulim bënë të kuptohet se Dardania vazhdoi të konsiderohet si identitet kulturor shumë i rëndësishëm, pavarësisht faktit që ky territor bënte pjesë në kuadër të Perandorisë Bizantine, para kësaj kohe Dardania qe bërë pjesë e provincave romake, gjegjësisht të Mezisë së Epërme. Sipas Prof. Arben Hajdarit "Ulpiana ka qenë ndër vendbanimet më të rëndësishme në Ballkan, në rangun e municipiumit; ka qenë qendër e dijes, e kulturës, e prodhimit, qendër artizanale dhe tregtare, e cila ka grumbulluar kategori të ndryshme sociale, në të cilën kanë gravituar njerëz të ndryshëm dhe ka qenë si vend ku janë lidhur interesa politike dhe ekonomike." Në Ulpianë po ashtu kanë jetuar familje të njohura senatoriale, siç kemi rastin e familjes Furi dhe Ponti. Fakti që në Ulpianë ka pasur familje të rëndësishme nga Roma dhe kanë ardhur në Dardani e Ulpianë, kuptohet se ky qytet ka përfaqësuar diçka shumë të rëndësishme. Ulpiana po ashtu është quajtur edhe si Qyteti i Mermertë dhe Qyteti Madhështor.

Për kohën të cilën është gjetur zbulimi (shek.VI), përshkruhet edhe ruajtja ose konservimi i këtij identiteti kulturor, gjë që është me rëndësi të madhe historike, pasi që flitet për një periudhë në prag të dyndjeve barbare të cilat ndodhin në Ballkan. Ilir Culaj tregon se "prezenca e këtyre kishave në Ulpianën antike, rindërtimi i qytetit, dedikimet me urdhër nga vetë erandori, është një dedikim i cili gjendet rrallë në perandori. Gjitha këto na tregojnë për peshën dhe rëndësinë që ka luajtur ky territor në atë kohë." Po ashtu, sipas tij, Ulpiana na flet edhe për një organizim të mirëfilltë të krishterimit në Dardani, që rezulton se njerëzit e ardhur nga dyndjet e shek.VI, e kanë pranuar krishterimin në kontakt me popullatat lokale. Njerëzit që erdhën nga dyndjet e mëdha, kanë gjetur një kulturë dhe civilizim të mirëzhvilluar. Ai shton se "në Ulpianën antike kemi arritur të identifikojmë pesë kisha në sipërfaqe të vogël të gërmuar, dhe kur Ulpiana antike gërmohet në sipërfaqe më të thella dhe më të gjera, besoj se do gjejmë edhe një numër të madh të kishave dhe objekteve tjera profane, utilitare etj... Pësja dhe vlera historike e këtij qyteti është e jashtëzakonshme."



Foto nga gërmimet, Ulpianë, Kosovë



Foto nga gërmimet, Ulpianë, Kosovë

Arkeologu francez, Prof. Chrisophe J. Goddard, njëherazi edhe udhëheqës i grupit francez të gërmimit, thekson se është shumë e rrallë të gërmohet në një lokalitet të paprekur dhe të pa dëmtuar nga gërmimet apo kushte të tjera. Ai, mbi të gjitha, e quajti këtë një "fat arkeologjik" për t'u shpërfaqur diçka e tillë, gjë që njëkohësisht i jep satisfaksion për të ardhmen e projektit në këtë lokalitet. Arben Hajdari e cilëson po ashtu këtë si fat arkeologjik sepse "për arkeologët, kjo është një minierë e arit... është e jashtëzakonshme." Mirëpo, krahas kësaj, në kuptimin shkencor, është një fat i pa eksploruar dhe sipas fjalëve të Arben Hajdarit "në momentin e parë që po e eksploron, po e zbulon, arrin ta bësh me folë, dhe po ia rikthen madhësinë që dikur e ka pasur. Kjo sigurisht që është edhe përgjegjësi e madhe, sepse nuk është e lehtë të bësh gurët të flasin."

Duhet theksuar faktin se, bashkëpunimi mes ekipit francez, studiuesve të Departamentit të Antropologjisë dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës, rezultoi me një zbulim të jashtëzakonshëm. Ky projekt ka filluar nga viti 2017 mes Christophe Goddard, Arben Hajdarit dhe Milot Berishës. Fillimisht projekti është bazuar në pikëpyetjet e mëdha që ekzistonin

rreth qytetit të Ulpianës. Arben Hajdari tregon se "arsyeja përse nuk kemi mundur të japim përgjigje të pyetjeve për Ulpianën, vjen si pasojë e mungesës së gërmimeve arkeologjike." Rrugëtimi i përgjigjes së dilemave të mëdha filloi kur u krijuan kushtet dhe rrethanat e reja për gërmime, të cilat gradualisht filluan edhe në hapësira tjera të lokalitetit të parkut antik të Ulpianës. Fillimisht, filluan incizimet gjeofizike, ku dyshimet mbi historinë e Ulpianës vetëm sa u përforcuan. Me fillimin e studimit të ri në qytetin Justiniana Secunda, erdhi edhe një kapitulli i ri për arkeologjinë në Kosovë. Gërmimet në bazilikën e gjetur kanë filluar në korrik të vitit 2022, ku është zbuluar se bazilika përbëhet prej 3 nefeve, kurse në vitin 2023 kanë filluar gërmimet në nefin qendror në të cilin është gjetur mozaiku me mbishkrim dhe, dy nefet tjera anësore, të cilat janë me tjegulla/pllaka. Fati ishte se, këto lokalitete të nëndheshme ishin ruajtur nga dëmtimet atmosferike, dëmtimet moderne, e çfarë ka ndikuar në ruajtjen e kësaj hapësire është se 120 hektarë të zonës së Ulpianës janë të mbrojtura me ligj dhe nuk lejohet intervenim në të.

Për t'i dhënë vlerë këtyre zbulimeve, hapi i parë është identifikimi zonës, hap të cilit Ilir Culaj i referohet me humor si "skanimi i tokës" me metoda bashkëkohore gjeofizike. Pastaj vjen procesi i gërmimit, i cili në të njëjtën kohë bënë edhe dokumentimin e lokalitetit të gërmuar. Këtu është e rëndësishme që asnjë detaj të mos ikë pa u konsultuar dhe verifikuar, kjo arsye e bënë arkeologjinë shpesh të ngadalshme si proces. Pas dokumentimit vjen evidentimi i artefakteve dhe gjetjeve. Menjëherë pas shfaqjes së artefaktit bëhet mbrojtja e kujdesshme për të mos u dëmtuar objekti. Në këtë rast, mozaiku është pastruar disa herë për t'u bërë i lexueshëm. Mbrojtja e përkohshme e mozaikut është bërë përmes vendosjes së gjeotekstit, e cila e vështirëson kontaktin me rërën e imët që vendoset mbi të. Pasi që kjo përfundohet, vjen hapi i radhës i interpretimit dhe analizimit të mbishkrimit dhe artefakteve të gjetura, kjo bëhet kryesisht nga udhëheqësit e projektit dhe ekspertët të fushave të ndryshme. Bazuar në interpretime dhe analiza, bëhet publikimi shkencor, i cili është pjesë e procesit të valorizimit. Ky është hapi i fundit që bënë zbulimin të gatshëm për prezantim publik, dërgohet në muze për qëllim që të prezantohet tek njerëzit. I gjithë ky proces bëhet me qëllim që të jepet një pasqyrë sa më e qartë e organizimit të qytetit të Justiniana Secunda. Se çfarë do të ndodhë me mbishkrimin në mozaik, ende nuk dihet, por se do të mbrohet e ruhet e studiohet me dedikim, kjo nuk vendoset fare në dyshim.

Profesor Arben Hajdari shprehet se “nëse më herët është gërmuar e është shkruar për arkeologjinë, duke e pasur në mendje vetëm studiuesin, sot kjo qasje ka ndryshuar. Sot, punohet duke e pasur në mendje publikun e gjerë dhe masivizimin e disiplinës. Pra, puna kryesore nuk përfundon në lokalitet, por fillon nga aty. Arben Hajdari thekson se “për arkeologët artefaktet japin mundësinë për t’i dhënë shpirt dhe jetë të kaluarës dhe ndihmojnë në rikonstruktimin e përditshmërisë së njerëzve që kanë jetuar në atë kohë dhe hapësirë.” Për t’u bërë hulumtimi publik, nevojiten edhe muzeologë dhe kuratorë, me qëllim që të paraqesin sa më mirë narrativat të cilët arkeologët i krijojnë pikërisht për edukimin e masës mbi të kaluarën e tyre. Sipas Arben Hajdarit, Kosova nuk qëndron mirë në këtë aspekt, sepse sipas tij ka shumë hulumtime të cilat nuk janë të ndara me publikun. Disiplina e arkeologjisë është e detyruar t’i transmetojë publikut gjetjet dhe interpretimet e arritura.

Lokaliteti i Ulpianës është një vend bashkëpunimi, i cili i lidhë të gjithë studiuesit dhe gërmuesit në një interes të përbashkët: vlera që përfaqëson lokaliteti. Këtu pastaj gërshetohen shkolla të ndryshme. Gërshetohen dije, mospajtime, diskutime të shumta, që bëhen në funksion të marrjes së njohurive të asaj se çfarë ka ndodhur. Të gjitha këto elemente ndihmojnë mbi interpretimin e një realiteti të lashtë.



Ambasadori Jeffery M. Hovenier duke ndihmuar në gërmimet në Ulpianë, Kosovë



Foto nga gërmimet, Ulpianë, Kosovë

Në gërmimet e Ulpianës vijnë kolegë të ndryshëm nga Franca, Britania e Madhe, Italia, Japonia etj., po ashtu edhe studentë nga vende të ndryshme. Ky bashkëpunim, sado që ka sfidat e veta krijon një energji të lartë të punës dhe bashkëveprimi, ndarjes së eksperiencave në ditët e gjata e të nxehta të verës. Projekte të tilla janë tejet të rëndësishme për arkeologët e së ardhmes. Arben Hajdari, me plot vullnet, tregon se i ka kushtuar shumë rëndësi dhe ka

kushtuar shumë kohë që të krijojë edhe një shkollë arkeologjike në Ulpianë. Në këto projekte, studentët vijnë të afirmohen, të mësojnë teknika të reja, të edukohen, të mësojnë për aplikime të metodave bashkëkohore, eksperiencë e cila i ndihmon në përcaktimin e duhur profesional për të ardhmen dhe për krijimin e metodave personale të kërkimit dhe hulumtimit. Mbi të gjitha, krijon kontakte të reja, fitojnë perspektiva të reja për të ardhmen.

Projekti do të zhvillohet edhe në vitet në vazhdim, derisa të arrihet të jepen përgjigje të shumë pyetjeve që kanë të bëjnë me transformimin e Ulpianës.

Leximi i tërë mbishkrimit të përkushtimit të Perandorit Justinian pritet të bëhet në vjeshtë 2023, i cili do përforcohet nga një publikim shkencor në të ardhmen.



Foto nga gërmimet, Ulpianë, Kosovë

Gërmimet në Lin të Pogradecit



Foto nga gërmimet në Lin, Pogradec, Shqipëri

Departamenti i Antropologjisë ofron gjithashtu mundësi angazhimi të ndryshme për studentë, me universitetet shqiptare dhe ndërkombëtare, si në rastin e dy studenteve të arkeologjisë nga departamenti ynë: Migena Mustafa dhe Diana Prenaj. Ato patën mundësinë të përfitojnë përvojë përmes gërmimeve arkeologjike në Lin të Pogradecit gjatë vitit 2022. Bëhet fjalë për një projekt me bashkëpunim të Universitetit të Bern-it dhe Institutit Arkeologjik të Shqipërisë, ku studentët e arkeologjisë nga Departamenti ynë, ishin pjesëmarrës. Këto gërmime kanë ofruar një përvojë të veçantë për këto studente, pasi që bëhet fjalë për gërmimet nënujore. Rëndësinë e pjesëmarrjes në ekspedita të tilla arkeologjike e tregojnë dhe vetë ato:

“Në gusht të vitit 2022 mora pjesë në gërmimet arkeologjike në Lin të Pogradecit. Ishte viti i dytë i projektit, i cili mbahet në bashkëpunim mes Fakultetit të Bernit dhe Institutit Arkeologjik të Shqipërisë. Në këtë projekt morëm pjesë dy studente nga Kosova dhe katër studentë nga Zvicra, si dhe ekspertë të fushës nga Shqipëria dhe Zvicra. Ishte një gëzim i madh kur kuptova se do të marr pjesë në këtë projekt, pasi që ishte hera e parë për mua që kam marrë pjesë në një projekt gërmimi kaq të madh dhe kaq të rëndësishëm. Aty qëndruam për një muaj dhe gjatë gjithë muajit ne kemi zbuluar gjëra shumë të rëndësishme. Ndër zbulimet më të shpeshta ishin copat e qeramikës neolitike. Këto copa ishin shumë të brishta dhe ishte emocionuese kur i gjenim, i nxirrim nga dheu dhe i pastronim ato. Gjetje të tjera ishin edhe copa të drurit, apo palafitet, që u përdorën për ndërtimin e strukturave të drurit dhe kasolleve në atë kohë. Edhe këto palafite ishin shumë të brishta dhe duhej të bënim kujdes me to. Po ashtu, kemi gjetur edhe eshtra kafshësh, të cilat na bënë me dije se aty me të vërtetë njerëzit po zhvillonin jetën e tyre. Gjatë gërmimeve, ne nuk mësuam vetëm për metodat e gërmimit, por edhe të pastrimit e dokumentimit. Çdo herë që kishte një gjetje duhej që t'i bënim gati një qese, ku gjetja të vendosej, si dhe një letër që shënoheshin të dhënat e gjetjes se në cilën shtresë është gjetur, datën, dhe materialin. Ishte shumë e rëndësishme që të ishim të vëmendshëm dhe të mbanim mend se në cilën shtresë po zhvillohej puna. Gjatë dokumentimit të gjetjeve, ne bënim edhe skica të gjetjeve në formulare të posaçme, ku përafërsisht mundoheshim të tregonim vendgjetjen e saktë, sidomos të palafiteve. Po ashtu, kemi bërë edhe skica të shtresave që shiheshin në profilet e sondës. Në këtë mënyrë, unë mësova se si të bëjë dallimin në mes llojeve të dheut, ku të vërej djegie apo ndërhyrje, etj. Në fund të ditës bëheshin edhe matjet me teodolit të pikave të caktuara paraprakisht

në sonda si dhe fotogrametria me anë të dronit. Procesi i pastrimit të gjetjeve dukej relaksues, po në të vërtetë ishte stresues. Edhe pse puna kryej kur je ulur dhe nën hije, duhej të kishim shumë kujdes, sepse siç thashë më parë, gjetjet ishin shumë të brishta. Ka pasur raste ku sa kisha një copë qeramike në dorë duke e pastruar, ajo ose thehej më shumë ose edhe shpërbëhej si të ishte dhe i pa pjekur. Me copat e palafiteve duhej kujdes që të mos dëmtonim unazat e drurit, ndonjë grithje apo ndonjë vrimë, pasi që aty mund të kuptonim ndërhyrjen e njeriut që i ka përdorur ato për ndërtim. Eshtrat ishin më të lehta për t'u pastruar, pasi që ato nuk e mbanin dheun shumë dhe nuk prisheshin lehtë. Në to kemi vërejtur grithje që mund të jenë nga veglat e njeriut. Përveç punës, ne krijuam edhe shoqëri të re, mësuam nga eksperiencat e njeri-tjetrit dhe bënim qejf. Edhe pse puna ishte e lodhshme, ishim krenar që punuam aty dhe nxorëm në pah diçka shumë të rëndësishme. Publikimet që u bënë këtë vit për këtë vendbanim, na gëzuan shumë, sepse ishim ne, një ndër ata persona që punuan aty dhe ishim ne ata që ndihmuam ekspertet të tregojnë më shumë për vendbanimin e Linit. Përmes këtij projekti, unë e kam vërejtur që puna në terren është shumë e rëndësishme për ne si arkeologë të rinj. Nuk ka rëndësi sa ke mësuar nga librat e nga profesorët, po nuk e vure në praktikë. Shpresoj që gjeneratat e reja të kenë nderin të marrin pjesë në projekte të tilla, jo vetëm në Shqipëri por edhe në Kosovë. Profesorët tanë janë gjithmonë të gatshëm që të na ndihmojnë neve, kështu që, ju si lexues të kësaj dhe si studentë, qoftë të arkeologjisë, antropologjisë, historisë, mos ngurroni që t'ia kushtoni disa ditë të pushimit veror një projekti arkeologjik. I falënderoj shumë ass. Ilir Culaj si dhe prof. Adrian Anastasi që më dhanë mundësinë që të marrë pjesë në këtë projekt.”

- Diana Prenaj

“Po bëhet një vit që nga gërmimet e mia në Lin të Pogradecit dhe, si studente e diplomuar në fushën e arkeologjisë besoj se ishte mjaft e nevojshme një eksperiencë e tillë. E nisëm me metoda jo-intruzive, që nuk shkaktonin dëme për të kontrolluar perimetrin e terrenit, por ishin evidencat ato që na motivuan që për një muaj të tërë të gërmojmë thellësi mbi 2m një lokalitet të periudhës parahistorike dhe rezultatet e gjetura të pasurojnë historinë e vendit tonë. Është vështirë të besojmë histori pa fakte të prekura, andaj dhe u zhvillua arkeologjia në vete, e jo në saje të historisë. Është lehtë kur prekim faktet e tilla me të cilat shkruajmë vetë historinë, dhe kjo, është shumë atraktive për një student të kësaj fushe. Eksperienca e tillë për mua filloi falë prof. ass. Ilir Culaj i cili besoi në aftësitë e mia gjatë studimeve dhe më bëri pjesë të një studimi kaq me rëndësi, e përpos meje si studente e Universitetit të Prishtinës, të përfshirë ishin profesorë e studentë nga Universiteti i Bernit të Zvicrës dhe prof. Adrian Anastasi, i njohur për arkeologjinë nënujore në Shqipëri. Gjetjet që bënim çdo ditë na motivonin që ditën tjetër ta nisim me më motiv e vullnet për të vazhduar tutje, meqë studimet nuk mbarojnë me një artefakt. Gjetjet përfshinin qeramikë të ndryshme me ngjyrë të errët nga periudha e neolitit dhe drunj të gjatë, që na rezultuan me një vendbanim palafit të kësaj periudhe. Me gjetje të tilla, ne hapëm një hulumtim të ri e të gjerë për këtë vend, e që si i tillë synonte të jetë një ndër lokalitetet më të vjetra në Evropë. Me këtë përvojë, do jem e gatshme që rrugëtimin tim si arkeologe, ta vazhdoj në vende e lokalitete tjera të llojit të njëjtë, duke përvetësuar aftësi e njohuri të reja në këtë fushë kaq me perspektivë e rëndësi. Besoj se nuk do jetë hera e fundit që do shkruajmë fakte të reja dhe interesante për vendin tonë, andaj jemi ne ata që duhet të veprojmë e mos t'i japim mundësi kohës që me shpejtësi të mbulojë rrënjët e historisë sonë. Jemi ne që mund të bëjmë ndryshimin, e jo vetëm në këtë fushë. Prandaj, çdo mundësi e dhënë duhet marrë aq seriozisht që me punën tonë të hapim hapësirë për çdo student të ri, sepse secili meriton një eksperiencë të tillë, ndërkaq dashuria për arkeologjinë veç do shkojë e do rritet.”

-Migena Mustafa



Foto nga gërmimet në Lin, Pogradec, Shqipëri

Intervistë me Michael L. Galaty

Profesor Michael L. Galaty është arkeolog amerikan i cili ka marrë titullin e doktoratës në antropologji nga Universiteti i Wisconsin-it. Ai ka drejtuar projekte të gërmimit arkeologjik në Greqi dhe Shqipëri. Profesor Galaty ka specializuar në parahistori dhe ka shkruar një sërë punimesh shkencore e librash. Aktualisht është redaktor i Doracakut të Oksfordit për Parahistorinë e Ballkanit, një vëllim që do të dalë në dritë së shpejti.

Më poshtë mund të gjeni një intervistë që kemi bërë me të në lidhje me përvojën e tij me projektin “RAPID-Kosova”.

1. A mund të shpjegoni rëndësinë e përfshirjes së komunitetit dhe bashkëpunimit me palët vendase në projektet tuaja arkeologjike? Si ka ndikuar ky partneritet në rezultatet e hulumtimeve tuaja në Kosovë?

Faza e parë e projektit tonë në Kosovë (RAPID, 2018-2021) u fokusua në një hulumtim intensiv rajonal të pjesëve të Rrafshit të Dukagjinit. Ekipet e vogla të hulumtuesve kërkuan sistematikisht këtë pjesë për artefakte. Një aspekt i kësaj lloji pune arkeologjike është se vjen në kontakt të përditshëm me njerëzit që jetojnë dhe punojnë në ato zona. Çdo ditë në fushë, hulumtuesit e sondazheve RAPID angazhoheshin me anëtarë të komunitetit dhe bashkëpunonin me palët vendase. Shpesh, ata ftonin hulumtuesit në shtëpitë e tyre, për kafe ose raki. Kjo na lejoi të ju tregojmë palëve të interesuara për punën tonë - dëshirën tonë për të kuptuar të kaluarën e Kosovës dhe për ta mbrojtur atë - dhe për palët e interesuara të na tregonin ku mund të gjenim vende arkeologjike. Ky lloj komunikimi shpesh çon në “zbulime” në shenjëtimin arkeologjik, pasi njerëzit vendas, sidomos fermerët, posedojnë një instinkt intim mes tokës së tyre, që shpesh është i trashëguar ndër breza.

2. A mund të ndani një moment të veçantë ose zbulim nga puna juaj arkeologjike në Kosovë, që ka pasur një ndikim të rëndësishëm në kuptimin tuaj për historinë dhe kulturën e Kosovës?

Kujtimi më i paharrueshëm për mua ndodhi në vitin 2019, kur hulumtuesit u kthyen nga fusha me shumë

artefakte arkeologjike të parahistorisë nga afërsia e Llugës pranë Vrellës. Ata zbuluan një vendbanim të ri, shumë të madh të periudhës së neolitit të vonë, i cili mendohet se mund të ketë funksionuar si një punishte për gurë. Që atëherë, kandidatja për doktoraturë në Universitetin e Michiganit, Zhaneta Gjyshja, ka kryer hulumtimin e saj të disertacionit në Llugë, me rezultate fantastike. Ajo ka kryer mbledhje të sipërfaqeve të shtruar në rrjetë të drejtpërdrejtë, së bashku me hulumtime gjeofizike dhe, ajo mendon se aty mund të ketë shumë shtëpi të gjata dhe një rrethim me kanal. Ka shumë vendbanime të tilla të periudhës së vonë neolitike, të njohura si “Vinca”, në Kosovën Lindore, por shumë pak në Rrafshin e Dukagjinit, kështu që zbulimi i Llugës është një ngjarje e madhe. Zhaneta madje ka gjetur dy fragmente të figurinave prej guri.

3. A mund të na tregoni për rëndësinë e projektit RAPID-K dhe zbulimet e tij në rajonin e Pejës dhe Istogut dhe, si ka kontribuar ky bashkëpunim mes Universitetit të Michiganit dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës në njohjen më të gjerë të peizazhit arkeologjik në Kosovë?

Projekti RAPID-K përfitoi nga puna që ishte bërë tashmë në Dukagjin, nga njerëz si Haxhi Mehmetaj, Shafi Gashi, Kemajl Luci dhe Premtim Alaj. Atlaset që IAK publikoi na dhanë një ide të mirë për vendndodhjen e vendeve dhe periudhave. Hulumtimet që kishin kryer në Kosovë përpara RAPID-K, ishin të natyrës ekstensive, ndërsa hulumtimet tona ishin intensive.

Hulumtimet intensive kanë tendencë të zbulojnë shumë më shumë, ndonjëherë vende arkeologjike më të vogla dhe të përcaktojnë më saktë madhësinë dhe kronologjinë e tyre, krahasuar me hulumtimet ekstensive. Kështu, kemi qenë në gjendje të marrim hartën arkeologjike të Dukagjinit dhe të shtojmë thellësinë dhe precizionin. Përveç kësaj, sepse të gjitha të dhënat tona kanë hyrë në një Sistem Informacioni Gjeografik (GIS) - punë e bërë nga kandidatja për doktoraturë në Universitetin e Michiganit, Erina Baci - tani jemi në pozicion për të përcaktuar faktorët që kanë ndikuar në vendosjen e vendbanimeve në këtë zonë. Ne mund të themi kështu me më shumë vetëbesim, jo vetëm se disa njerëz kanë jetuar në fortesa malore, por pse kanë jetuar atje. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për arkeologjinë e Kosovës por për Ballkanin në përgjithësi, ku fortesat malore studiohen rrallë, me kujdes dhe sistematikisht, të mbështetura nga të dhënat e hulumtimeve rajonale.

4. Cfarë mendoni për perspektivën e studimeve antropologjike dhe arkeologjike në Departamentin e Antropologjisë në Universitetin e Prishtinës?

Departamenti i Antropologjisë i Universitetit të Prishtinës është një shembull i rrallë në Evropë i një programi me katër fusha të stilit amerikan. Në shumë pjesë të Evropës, antropologjia kulturore dhe biologjike, etnolinguistika dhe arkeologjia mësohen ndarazi. Megjithatë, unë besoj, siç besojnë shumë antropologë amerikanë, se ka shumë për të fituar kur fushat e ndryshme antropologjike koekzistojnë. Punimet e bëra nga etnologët mbi sjelljet moderne të njeriut mund të informojnë kuptimet arkeologjike të së kaluarës dhe, të dhënat arkeologjike mund të përdoren për të trajtuar probleme bashkëkohore. Jam shumë i entuziazmuar nga hulumtimet ndërdisiplinore që po zhvillohen nga kolegët e mi në Departamentin e Antropologjisë të UP-së dhe shpresoj për bashkëpunime më të ngushta me ta. Më e rëndësishmja, jam i kënaqur që do të marr më shumë studentë të UP-së në projektin RAPID në fazën tonë të ardhshme, e cila do të përqendrohet në zbulime arkeologjike.



Michael L. Galaty me djalën e tij Dardan-in, në Llugë, Kosovë

I lumtur u ktheva në Ulpianë (Nga Jean-Luc Lamboley në kujtim të Edi Shukriut)

Pas shumë vitesh, kisha rastin të rikthehem në këtë lokalitet, ku në vitin 2006 kisha mundësinë të nisja bashkëpunimin e parë arkeologjik franko-kosovar me profesoreshën, arkeologjen Edi Shukriu. Pjesëmarrja për disa vite më radhë në shkollën verore arkeologjike të Universitetit të Prishtinës, ku ofronim kursin e arkeologjisë, ishte një mundësi që të njihem me studentët, ku disa prej tyre erdhën në Francë për të vazhduar studimet e tyre, master dhe të doktoratës. Para daljes në pension, në vitin 2017, pishtarin ja kalova kolegut tim Christophe Goddardit, i cili shkëlqyeshëm i dha një shtysë të re këtij bashkëpunimi arkeologjik me profesor Arben Hajdarin dhe drejtorin e parkut arkeologjik të Ulpianës, Milot Berishën. Falë ftesës dashamirëse të udhëheqësve të misionit, mora pjesë në kampanjën arkeologjike të vitit 2023 dhe pashë me kënaqësi përparimin e madh të bërë që nga viti 2006. Mjetet teknike të përdorura shpjegojnë pjesërisht këtë përparim: drona, stacion total i automatizuar, mjete të cilësisë së lartë për fotogrametri, panele fotovoltaike, aq shumë mjete që nuk i kishim në kohën kur trekëndëshat dhe formularët e skedave kishin ende disa germa ktyneheri! Të gjitha këto arritje janë mbi të gjitha falë një ekipi shumë të kualifikuar, të bashkuar nga lidhje të forta nderimi dhe miqësie. Ky është një tjetër gëzim i vërtetë kur shohim se studentët që kemi trajnuar dhe kolegët, tek të cilët kemi besuar, janë në gjendje të japin më të mirën në një kontekst multietnik, gjë që në Kosovë, ne e dimë, nuk është gjithmonë e lehtë. Së fundi, nuk mund ta mohojmë lumturinë që sjell një zbulim i jashtëzakonshëm me interes të madh shkencor. Momentet kur, pas javësh pune të palodhur në vapë përvëluese, ngadalë, njëra pas tjetrës, rresht pas rreshti, shkronjat u shfaqën në mozaikun e kishës,

gërmimet në të cilën kishin filluar vitin e kaluar, ishin një lloj apokalipsi befasues: rreshti i parë paksa enigmatik, linja e dytë perandorake me Justinianin, linja e tretë prapë perandorake me Teodorën dhe së fundi, ajo që nuk do të kishim shpresuar kurrë..., përmendja e Dardanisë në rreshtin e katërt! Ky zbulim mobilizoi të gjithë autoritetet politike dhe shkencore të Kosovës; por çfarë mund të jetë më e bukur se lumturia e përbashkët? Kishte vetëm një hije në gëzimin tonë, mungesa e Edi Shukriut që na kishte lënë disa muaj më parë. Kjo është pjesë e jetës: ndoshta nganjëherë kemi nevojë për një copë trishtimi për të matur dhe vlerësuar më mirë anët e lumturisë. Me vitet që kalojnë dhe kohën e lirë të daljes në pension, kemi kohë për të medituar dhe për të reflektuar, dua të tërheq vëmendjen e lexuesit në një pikë që është padyshim irrituese për arkeologët dhe historianët: kalimi i kohës dhe shtresimi i shekujve rrallë e lejojnë historinë të rishfaqet e paprekur dhe e plotë nga toka (dalla terra sipas shprehjes së bukur italiane): mbishkrimi i zbuluar në Ulpianë, pothuajse tërësisht i ruajtur, megjithatë ruan një pjesë të vogël të misterit. Nga ana ime, lumturia ime mbetet e plotë, sepse kjo fushatë e papritur gërmimi në të cilën, padyshim, një destinim dashamirëse më lejoi të merrja pjesë, më largoi nga një nostalgji melankolike për aktivitetet e kaluara për të orientuar mendimin drejt një të ardhmeje plot shpresë, atë të brezave të rinj në trajnimin e të cilëve kam marrë pjesë në mënyrë modeste. Dhe për këtë, ju dërgoj një falënderim të madh të gjithë atyre dhe ka shumë, për të cilët kam pranuar të shkruaj këta pak rreshta.

- Jean-Luc Lamboley
Professeur émérite de l'Université de Lyon

Un retour à Ulpiana plein de bonheur

En hommage à Edi Shukriu

Depuis plus de trois ans, je n'avais pas eu l'occasion de revenir sur ce site où, en 2006, j'avais pu ouvrir la première collaboration franco-kosovare avec la professeure Edi Shukriu. La participation plusieurs années consécutives à l'école d'été de l'Université de Prishtina où l'on avait ouvert un cours d'archéologie, était aussi l'occasion de connaître les étudiants dont certains d'entre eux vinrent en France poursuivre leurs études de master et de doctorat. Avant mon départ à la retraite, j'avais pu passer le flambeau en 2017 à mon collègue Christophe Goddard qui sut donner avec brio une nouvelle impulsion à cette collaboration archéologique avec le professeur Arben Hajdari et le directeur du parc archéologique d'Ulpiana Milot Berisha. Grâce à l'aimable invitation des directeurs de la mission j'ai donc pu participer à la campagne 2023 et mesurer avec bonheur les énormes progrès réalisés depuis 2006. Les moyens techniques utilisés expliquent en partie ces progrès : drones, station totale automatisée, logiciels de photogrammétrie ultra performants, panneaux photovoltaïques, autant de moyens dont on ne disposait pas à l'époque où la triangulation et les fiches US papier avaient encore quelques lettres de noblesse! Mais ils sont surtout dus à une équipe homogène, hautement qualifiée et soudée par de solides liens d'estime et d'amitié. C'est là un autre vrai bonheur quand on voit que les étudiants que l'on a formés et les collègues en qui on a placé sa confiance sont capables de produire le meilleur et ce dans un contexte multi-ethnique qui au Kosovo, on le sait, n'est pas toujours facile. Enfin, on ne saurait nier le bonheur qu'apporte une découverte extraordinaire et d'un grand intérêt scientifique. Les moments où sont apparus, après des semaines de dur labeur dans une chaleur caniculaire, lentement, l'une

après l'autre, ligne après ligne, les lettres sur la mosaïque de l'église dont les fouilles avaient commencé l'an dernier, furent une sorte d'apocalypse haletante : première ligne un peu énigmatique, deuxième ligne impériale avec Justinianus, troisième ligne toujours impériale avec Théodora et enfin, ce qu'on n'aurait jamais espéré..., la mention de la Dardanie à la quatrième ligne ! Cette découverte mobilisa toutes les autorités politiques et scientifiques du Kosovo, mais quoi de plus beau qu'un bonheur partagé ? Il n'y avait qu'une seule ombre à notre liesse, l'absence d'Edi Shukriu qui nous avait quittés quelques mois auparavant. Cela fait partie de la condition humaine : il faut peut-être une part de tristesse pour mieux mesurer et apprécier les parts de bonheur. Avec les années qui passent et le temps libre de la retraite on a le temps de méditer et pour conclure j'aimerais attirer l'attention du lecteur sur un point sans doute irritant pour les archéologues et historiens : l'usure du temps et l'épaisseur des siècles permettent rarement à l'histoire de resurgir intacte et entière de la terre (dalla terra selon la belle expression italienne) : l'inscription, presque entièrement conservée, conserve toutefois une petite part de mystère. Pour ma part, mon bonheur reste entier car cette campagne de fouilles inespérée à laquelle sans doute une providence bienveillante m'a permis de participer, m'a détourné d'une mélancolique nostalgie des activités passées pour me projeter vers un avenir plein d'espérance, celui des nouvelles générations à la formation desquelles j'ai modestement participé. Et pour cela, j'adresse un immense merci à tous ceux, et ils sont nombreux, pour qui j'ai accepté d'écrire ces quelques lignes.

- Jean-Luc Lamboley
Professeur émérite de l'Université de Lyon

Eksploruesit në terren



Foto nga terreni
Pamje e Kotofrit

Bubërrime etnografike nga Mali i Zi

Çdo vit, Departamenti i Antropologjisë organizon një udhëtim etnografik, ku marrin pjesë studentët dhe profesorët. Në të kaluarën, këto udhëtime janë realizuar në Shqipëri. Këtë vit radha i erdhi Malit të Zi. Itinerari i udhëtimit u organizua me qëllim të njohjes së disa vendbanimeve të veçanta që kanë rëndësi për fushën tonë të studimit.

Ky udhëtim u zhvillua nga data 22 deri më 24 maj 2023 dhe përfshiu 10 studentë të vitit të tretë të departamentit të Antropologjisë, bashkë me 3 profesorë që i shoqëruan ata. Ky udhëtim ishte i përqendruar në pjesën jugore të Malit të Zi, në qytetet dhe lokalitetet si Ulqini, Shasi, Kotori, Perasti, Rizoni, Dioclea, Podgorica, Tuzi dhe Tivari.

Ditën e parë të udhëtimit vizituam Shasin mesjetar, që gjendet në pjesën verilindore të Ulqinit, në afërsi të liqenit të Shasit. Ndonëse ky vendbanim njihet si mesjetar, konsiderohet se në afërsi të Shasit kemi një numër evidencash nga periudha antike, gjegjësisht edhe më herët. Por, duhet të theksojmë se Shasi njihet kryesisht për faktin se kishte 365 kisha, sipas Marin Bicit. Por, sot shohim vetëm gërmadha të disa prej tyre. Kisha e Shën Mërisë ka ende disa mure në këmbë dhe vërehet edhe nga rruga kryesore.

Pas vizitës së Shasit, **Arbina Qorri** dhe **Arbana Murtezi**, studente të vitit të tretë në drejtimin arkeologji, dhanë këto komente nga ditari i tyre etnografik.

“Për ne, Shasi paraqet një qytet të vjetër të periudhës para ardhjes së sllavëve, i cili ka pushuar së ekzistuari në vitin 1518. Në zonën më të lartë të qytetit vërehet qartë një kishë, e cila mbijeton sot e kësaj dite, mirëpo, për të cilën nuk ka interesim të madh. Arsyeja e cila nuk paraqet interesim, është shkak se kjo kishë i takon kishave katolike me një arkitekturë romane dhe nuk përkon me ritin ortodoks të kishave tek malazezët. Nga zona më e lartë duke zbritur gradualisht më poshtë vërehen edhe fortifikimet shkëmbore të ulëta, të cilat zbrasin gradualisht më poshtë përreth kësaj zone, duke filluar nga pjesa më e lartë e lokalitetit e deri në pjesën e poshtme në të cilën janë shtëpitë e pronarëve të sotshëm. Për sa i përket ruajtjes së këtij lokaliteti, vërehet se ky lokalitet është mbuluar nga

bimësia, kurse mosinteresi i shtetit nuk ka pse të vihet në diskutim, pasi kjo trashëgimi nuk i përket popullatës së tyre. Mirëpo, nga ana e popullatës shqiptare vendase vërejmë insistimin e tyre për të përshkruar pronarët e vërtetë të këtyre lokaliteteve, qoftë edhe duke gërvishur në dru një citat në gjuhën shqipe, brenda mureve të kishës së lartpërmendur.”

Ndërsa **Fatjona Berisha**, studente e antropologjisë kulturore (viti i tretë) jep një përshtypje specifike mbi vrojtimin e shkurtër të gërmadhave të Shasit.

“Me të filluar vrojtimin tonë, ne ndaluam në qytetin e Shasit, i panjohur për mua, por me një histori unike dhe të vjetër. Një vendbanim që daton që nga koha e neolitit, bazuar nga gërmimet që ishin bërë, dhe gjurmët që kishin mbetur deri në ditët e sotme. Si toponim, emri Shas sipas etimologjisë, thuhet se ka lidhje me shkamb (shkëmb), me indoevropianishten e lashtë emri i saktë lidhet me shkamb ose gurë, meqenëse ishte ndërtuar në pjesën më shkëmbore të trevës. Ajo çfarë më bëri përshtypje ishte një kishë që vizituam, mbetjet e së cilës i kishin mbijetuar kohës, edhe pse kujdesi nga vetë banorët apo njerëz të tjerë nuk ishte i madh. Është pa dyshim mëkat që një trashëgimi e tillë të mbetet nën hije, e të mos ketë një kujdes, apo një investigim më të madh, sepse ka një potencial dhe interesimi nga vizitorët qoftë vendas apo edhe të huaj, nuk do të mungonte. Në fakt, gjatë kohës kur ne mbërritëm atje, hasëm në disa vizitorë



Foto nga terreni Ecja e grupit në Shas

të huaj, që ndoshta as nuk kishin dëgjuar apo nuk dinin asgjë në lidhje me atë që kishin përballë, por kureshtja i kishte shtyë për të ardhur aty. Duke qenë një qytet me histori të lashtë dhe legjendja për Shasin kishte plot.”

Një mori fotografish u realizuan pranë dhe mbi gërmadhat e Shasit. Një diskutim i gjatë u zhvillua mbi “frëngjinë” e kishës, mënyrën e ndërtimit të mureve, pozitën gjeografike, mundësinë për të qenë një lokalitet i lashtë ilir i mbindërtuar më vonë, në kontekst të rindërtimeve të mbretërisë nemanjite e regjimeve të tjera mbi gërmadhat ilire. Shasi kishte një pamje magjike, një joshje për ta gërmuar tutje. Thuhet se edhe gërmimet e viteve 80 qenë ndërprerë pa ndonjë arsye të madhe akademike, por për arsye se gjetjet e reja s’i paskan pëlqyer arkeologëve serbë. Por, s’ka shpjegim, s’ka shenja të mjaftueshme.

Prej Shasit, vizita e pasdites së 22 majit vazhdoi në Ulqin, gjegjësisht në Kalanë e Ulqinit, ku na priti Korab Kraja. Korabi ka një njohuri të jashtëzakonshme për Ulqinin dhe trashëgiminë kulturore të tij, për historinë e vendit e të kalasë. Ai ka studiuar kullat e shtëpitë tradicionale të Krajës, krahinës prej nga vjen. Secilit i kujtohet kënga “Te Kalaja e Ulqinit”, e dikujt edhe “Dulçineja” e Don Kishotit, por kur vizitojmë kalanë, para syve na dalin muret ilire, gurët ciklopikë, që

kishin dalë në pah pas tërmetit të vitit 1979, kur qe bërë rievimi i kalasë. Kjo, është një prej madhështive të kalasë së Ulqinit. Aty na bashkohet arkeologu Anton Lulgjuraj, i cili na shpjegoi mjaft shumë për historinë e kalasë, Ulqinit, e rrethinës. Antoni nisi diskutimin me humor tipik për stereotipin e dembelisë së malazezëve : “Të dielën, më 21 maj ishte dita e pavarësisë së Malit të Zi, andaj të hënën është pushim, por malazezët pushojnë edhe të martën!”

Antoni e Korabi na treguan për vjetërsinë e kalasë, shekulli V p.e.s. Ata na treguan për atë se çfarë do të thotë të jesh ulqinak i kalasë, për identitetin e Ulqinit, për tërmetin e vitit 1979, që shkatërroi 80% të kalasë, por vendësit nuk e lëshuan kalanë për të dalë në shtëpi të reja jashtë saj. Ata qëndruan dhe vazhduan ta rindërtojnë jetën aty. Në një nga restorantet e kalasë, pamë pikurën e Ismailit, një nga ulqinakët që kishte qëndruar stoik ndaj kërkesës për ta braktisur kalanë pas tërmetit. Kjo tregon ngulitjen dhe mishërimin e shqiptarëve në kala, sipas vendësve. Pa dyshim, kalaja kishte pësuar edhe ndryshime, ishte shkatërruar nga ndërtimet pa leje dhe pa plan, të bëra së fundi, siç qe rasti i një ndërtese të destinuar për hotel, shkaku i së cilës qe prishur edhe muri jugor pranë detit. Dikush nga banorët tha se investitori qenka një rus. Studentët nuk arritën të njihen sa duhet me banorë lokalë. Kishte pak dhe kërshëria për të parë muzeun në pjesën e mbetur të ditës, bëri që të mos ndalen nëpër shtëpi të kalasë dhe të bisedojnë me vendas, siç kishin planifikuar.



Foto nga terreni Brenda Kishës së Shën Mërisë në Shas



Foto nga terreni Muri Ilir në kala të Ulqinit

Ulqini ka një histori, një histori tipike ballkanike, nën sundime të shumta, por karakteristika kryesore e këtij qyteti është fakti se është qyteti shqiptar që nuk bie nën sundimin osman deri në vitin 1571. Pastaj, në vitin 1878 bie në sundimin e Malit të Zi. Gjatë asaj periudhe zhvillohet pirateria e cila shndërrohet më vonë në tregti. Ndonëse, Muzeu Etnografik ishte nën renovim, ne vizitua Muzeun Arkeologjik brenda Kalasë, ku kishte një mori artefaktesh të veçanta nga kalaja dhe nga zona. Dallohet edhe veshja e zonës etnografike të Shestanit, që ishte brenda muzeut, një veshje e bukur e shqiptarëve të zonës.

Studentja e vitit të tretë **Arbesa Berisha** e ka përjetuar kështu Kalanë e Ulqinit:

“Karakteristika Kalasë së Ulqinit është se në periudhën e hekurit, ilirët ishin zotëruar të Detit Adriatik dhe nga kjo kala mbanin ofensivën mbrojtëse nga armiku. Çështje tjetër më rendësi, që mësova nga vizita ishte se, në vitin 1979 kishte rënë një tërmet i fuqishëm dhe kishte shkatërruar pothuajse çdo gjë në këtë kala. Por, pastaj qe rindërtuar. Këta njerëz që kanë jetuar në ato shtëpi nuk kanë lejuar që t’i boshatisin shtëpitë e tyre, rrënojat apo gërmadhat e tyre. Kishin rindërtuar jetën e tyre aty. Karakteristikë tjetër me rëndësi për këtë kala janë objektet (shtëpitë, kullat, hotelet, restorantet) që janë të ndërtuara shumë afër njëra tjetrës dhe, kryesisht të formës së njëjtë. Disa nga emrat e objekteve ishin: Kulla Balshajve, Tregu i Robërve, “New in Old Town”, Muri Ilir etj. Përpos emrave, veçanti tjetër ishin dhe shkrimet mbi këto

mure të kalasë që, në kohën osmane janë përvetësuar me shenjat e tyre duke i asgjësuar gjurmët vendase.

Ndërsa **Arbana Murtezi** dhe **Arbina Qorri** theksojnë se:

“Ulqini – njihet si vendbanim iliri themeluar në shekullin V. Edhe sot e kësaj dite brenda mureve të kalasë jetojnë ende familje, të cilët refuzojnë t’i lëshojnë tokat e tyre. Shumica dërrmuese e banorëve brenda kalasë janë shqiptarë ulqinakë. Ulqinakët brenda kalasë, me gjasë duhet të jenë shoqëri konservative sa i përket identitetit, pasi ata veten e quajnë ulqinakë të vjetër, banorë më të vjetër të Ulqinit, kurse kjo nuk vlen për ulqinakët jashtë mureve të kalasë. Kjo besoj se do të ketë vetitë e veta pozitive, si elemente mbizotërues në ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar.”

Pas Ulqinit dhe diskutimeve të shumta në mbrëmje për identitetin, shtetin, lashtësinë dhe ideologjinë, ditën vijuese më 23 maj, të martën, vazhduam me vizitë drejt Kotorrit. Rrugës Antoni na ndaloi te Manastiri benediktin i Rotecit (Sutomore), gjegjësisht vendi ku qenë kryer shumë aktivitete administrative e diplomatike, përfshirë edhe punën e shërbimit e abatit Gjergj Pelinit, që mbi të gjitha ishte një diplomat që kishte shkruar letra për Skënderbeun. Pelini ishte nga Novobërda. Ky manastir dukej paksa i harruar, sepse nuk kishte mjaftueshëm shpjegime në të. Antoni tregon se kishte shtypshkronjën e vet, spitalin e vet, bujtinën për udhëtarët etj. Ishte një lloj pike doganore, sepse lidhte Dalmacinë me Greqinë. Sa shumë letra do të duhej të ekzistonin nëpër arkiva të

shteteve të ndryshme, të shkruara nga Gjergj Pelini. Thjesht, ato duhet të zbulohen.

Pastaj vizituam Kotorin, Perastin dhe Rizonin. Kotorri venedikas ishte një prej qyteteve më të bukura, që studentët kishin parë. Muret e qytetit, restaurimi unik, mbrojtja nga UNESCO, vizitorët e shumtë, anijet madhështore në Gjirin e Kotorrit, qenë thjesht madhështore. Kotorri është në mbrojtje të UNESCO-s, për muret vendikase, bashkë me Perastin dhe disa ishuj përreth. Një nga ishujt, siç tregoi Antoni, që formësuar nga anijet e osmanëve të mbushura me gurë nga perestasisit. Osmanët s'kishin arritur asnjëherë që të pushtonin Kotorrin e Perastin, për arsye të mbrojtjes së fortë dhe pozitës gjeografike. Në Kotor, disa nga studentët e profesorët u ngjitën në malin sipër Kotorrit, për të shijuar pamjen magjepsëse prej atje. Pastaj, grupi vazhdoi drejt Rizonit, kryeqytetit të mbretëreshës ilire, Teutës. Përmendet në burimet antike pikërisht për shkak të disfatës së Teutës kundër romakëve dhe strehimit aty. Lart në shkëmbinjte përreth gjendet kështjella mbrojtëse. Ndërsa, muret e qytetit janë me gurë ciklopikë, njësoj sikurse ndërtimet e tjera ilire të kësaj zone. Këtu, gjithë grupi pati ndjenja të përziera. Në një anë ishte një ndjenjë e qartë e krenarisë se po shihnin qytetin e vogël ilir të Teutës e Agronit, e në anën tjetër, ky vend nuk kishte trajtim e mbrojtje të duhur nga shteti. Profetori Arben Hajdari duke u shpjeguar studentëve theksoi se, do të duhej të bëhej një gërmim sistematik në këtë lokalitet të lënë pas dore dhe potencoi nevojën për njohjen sa më të mirë të tij. Por, duket se disa nga këto lokalitete arkeologjike, si në Mal të Zi ashtu edhe në vende të tjera, por edhe në Kosovë, kanë mbetur krejtësisht jashtë fokusit. Prandaj, investimi në arkeologji, është jashtëzakonisht i nevojshëm.

Në mbrëmje u kthyem në Ulqin, ku vazhduam bisedat për Kotorrin, Rizonin, Skënderbeun dhe nevojën e bashkëpunimit në arkeologji. Studentët u ndjenë të frymëzuar pas vizitës në Rizon e Kotorr, sidomos në Rizon. Të shikosh muret e Teutës e Agronit, që ende janë të gjallë si vazhdimësi simbolike, si emërtime, por edhe si kërshtëri për t'i njohur më shumë, ishte thjeshtë "dhuratë e bukur e këtij udhëtimi", siç e cilësuan ata. Civilizimi ilir zgjon shumë kërshtëri, sepse në një anë është shkatërruar mjaft shumë, në anën tjetër, prej tij kemi mbijetoja të gjalla, siç është gjuha dhe kultura shqiptare, e në anën tjetër, rikonstruktohet mjaft shumë në imagjinatën shqiptare, nga mungesa e fakteve reale. Arkeologjia



Foto terreni nga Shasi, Mali i Zi



Foto nga terreni Gërmadha e Rizonit të Agronit dhe Teutës

dhe linguistika janë shtylla esenciale të shuarjes së kësaj etjeje kureshtare për ta njohur këtë civilizim dhe vendin e tij në histori.

Në ditën e fundit të udhëtimit, vizituam qytetin ilir të Dioklesë dhe fshatin Vuksanlekaj. Dioklea gjendet afër Podgoricës dhe është një nga vendbanimet më të rëndësishme në Malin e Zi. Pozita e këtij vendbanimi ilir ishte strategjike: pranë lumit Moraça dhe pranë maleve mbrojtëse përreth. Emrin e ka marr sipas fisit ilir të diokleatëve. Sikurse Djathi i Sharrit, njihet edhe Djathi Dioklean. Ky qytet ilir kishte afër 10 mijë banorë. Sot, gërmadhat e qytetit janë objekte në mbrojtje relativisht të mirë, por gërmimet duket se janë shterur. “Pse nuk është edhe ky një park arkeologjik si Ulpiana?”, pyetën studentët. Sot, qyteti është një gërmadhë e qytetit romak, me forume, banjo e arkitekturë tjetër, sepse Dioclea ra në sundimin romak, pastaj bizantin, nën sundimin e Balshajve, osman e me radhë. Vizita vazhdoi drejt fshatit të varrezave të veçanta, për arsye të simboleve në gurët e varrit, të fshatit Vuksanlekaj. Aty na priti arsimtari Luigj Camaj, që njeh mirë historinë e zonës. A nuk duhet që guida apo udhërrëfyesi apo cicëroni të jetë gjithmonë lokal? Po. Gjithmonë udhërrëfyesi duhet të jetë lokal. Antoni, Korabi dhe Luigji e dëshmuar këtë përfundimisht. Mikpritës, njohës të mirë, vetëkritikë në raste, të përgjegjshëm dhe krenarë për çfarë janë. Në fshatin Vuksanlekaj, ekzistojnë varrezat e vjetra, të cilat njihen si varreza misterioze. Por, pas vizitës, vrojtimit e analizës, Luigji tregon edhe kohën kur mbahen mend të jenë gdhendur gurët e varreve, që nuk kalon mbi 200 vite. Po ashtu, disa data ekzistojnë në këto varreza. Por, ana unike e tyre janë simbolet e shumta, që njihen kryesisht si pagane, në këto varreza të shqiptarëve të krishterë të kësaj zone. Këtu ka diej, yje, rozeta, motive të veshjeve e shkrime. Robert Elsie ka një shkrim për to, ndërsa Korab Kraja dhe Luigj Camaj po bëjnë një libër-katalog për to. Elsie i ka quajtur “[arti varrezor shqiptar](#)”. Thjesht, në një fshat të vogël gjendet një koleksion i mahnitshëm i artit popullor shqiptar.

Kjo qe një vizitë e jashtëzakonshme e grupit të Departamentit të Antropologjisë në Mal të Zi. Gresa Marmullaku tha se “kishte pasur një udhëtim fantastik”, ndërsa Arlinda Shatri e cilësoi këtë udhëtim si një ndër më të vlefshmit që ka realizuar ndonjëherë. Studenti e arkeologjisë, Sami Haziraj e vlerësoi këtë udhëtim si një “udhëtim në lashtësi”, sidomos pas vizitës në Rizon.



Foto nga terreni Varr në Vuksanlekaj

Vizitë etnografike në Karadak

Në rrjedhën e vizitave studimore për këtë vit, studentët e vitit të tretë të antropologjisë kulturore, nën udhëheqjen e profesor Arsim Canollit, vizituan 3 fshatrat e Karadikut, Stubllën, Letnicën dhe Binçën, për të reflektuar mbi antropologjinë e religjionit dhe identitetit, në kontekst të Evropës Juglindore. Regjioni i Karadikut paraqet një peizazh kulturor e religjioz të ngjeshur, rrjedhimisht të njohur për diversitetin kulturor të pasur dhe rëndësinë historike të tij. Kjo zonë, e vendosur në pjesën lindore të Kosovës, ka qenë një mishërim i kulturave të ndryshme, traditave dhe etnive për shekuj të tërë.



Foto terreni në Karadak, Kosovë



Foto terreni në Karadak, Kosovë

Stublla është vendi më unik për të mësuar për një histori specifike të laramanizmit e kriptokrishterimit në Kosovë. Letnica e kroatëve të ngulitur që 700 vite aty është një rrëfim i trishtë, sidomos pas eksodit të vitit 1991. Kanë mbetur vetëm dy motrat kroate mbi 80 vjeçare dhe disa pleq të tjerë kroatë, të cilët rrëfejné vështirësitë e tyre. Por, Letnica e Madonës së Zezë, është edhe vendi i dashur i Nënë Terezës, të cilin e kishte vizituar si e re. Në anën tjetër, Kisha në Binçë, një fshat më afër Vitisë, në muret e saj, rrëfen tregimin e afër 200 martirëve të Stubllës, familje shqiptare që dolën haptas si të krishterë në vitet 1840, që u internuan në Turqi nga Mahmut Pashë Gjinolli, por u kthyen afër 70 prej tyre, pasi të tjerët vdiqën atje. Prej tyre sot janë afër 10 mijë, por të shpërndarë në fshatra dhe nëpër Evropë.

Kjo vizitë e radhës plotëson kërkimin për njohjen e veçantive kulturore, të mozaikut kulturor të Kosovës. Në pamundësi për të vizituar vendet e tjera, këto vizita etnografike, njëditore dhe të fokusuar në një vend, shërbejnë si nxitje e hulumtimit të mëtutjeshëm empirik, që vlerësohet brenda lëndëve specifike të programit studimor në antropologji.



Foto terreni në Karadak, Kosovë

Festivali “Hasi Jehon”



Foto nga festivali “Hasi Jehon”, Has, Kosovë



Foto nga festivali “Hasi Jehon”, Has, Kosovë



Foto nga festivali “Hasi Jehon”, Has, Kosovë

Festivali folklorik “Hasi Jehon” sivjet u mbajt gjatë mbrëmjeve të 5,6 dhe 7 majit (2023), si zakonisht në fshatin Gjonaj të Hasit në afërsi të Prizrenit. Këtë vit, festivalin e përcolli profesori Arsim Canolli, i cili ishte edhe anëtar jurie i festivalit, bashkë me studentët e antropologjisë.

Në festival, sivjet pati shumë risi: vajzat e talentuara nga Deçani, ansamble të shquara nga Mati, Hasi, Dibra, Shkupi, Gollaku, Drenica dhe Vitia kanë performuar me profesionalizëm e pasion. Nata e dytë e festivalit u pasurua me prezencën e dy mysafirëve të veçantë nga SHBA, Teng dhe Mat, të cilët janë artistë dhe studiues të pasionuar për trashëgiminë kulturore. Teng Chamchumrus, i cili

ka punuar në Institutin Smithsonian në SHBA dhe është mbështetur nga Ambasada Amerikane, solli një frymë të veçantë në diskutimet mbi trashëgiminë kulturore dhe edukimin në Kosovë, si një këshilltar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Ai qëndroi në Kosovë për 1 muaj dhe gjatë kësaj kohe u ftua në organizime të ndryshme nëpër Kosovë. Në këtë rast ishte i ftuar nderi nga festivali “Hasi Jehon”, ku përcolli performancat e natës së dytë të festivalit.

Rapsodët, instrumentistët dhe valltarët kanë krijuar një përmbajtje të pasur artistike, duke sjellë një përvojë të mahnitshme për të pranishmit. Në skenën e festivalit u shfaq një gamë e pasur e paraqitjeve kulturore, duke përfshirë vajtimet e grave dhe gjamat e

burrave, të cilat u paraqitën si koncepte të vlerësuara në performancat artistike. Performancat përfshinë ritet e buzmit, ditën e petullave, ninullat e ëmbla, këngët e vajzave dhe rrëfimet gojore. Gjithashtu, u paraqitën edhe vallet dyshe, zërat polifonikë dhe tingujt e instrumenteve tradicionale si, lahuta, gjethi, fyelli dhe kavalli. Ky festival krijoi një mozaik të pasur të trashëgimisë kulturore të Kosovës, duke e bërë të dukshme pasurinë dhe diversitetin kulturor të vendit.

Festivali “Hasi Jehon” nuk përbënë karakter garues; më tepër është një shpërndarje e pasurisë kulturore dhe njohjes së vlerave të saj. Çmimet në këtë festival ndahen si një shenjë respekti për paraqitjet më të shquara, dhe vlerësimi është i bazuar në

performancën e tërë. Ky festival përfshin të gjitha aspektet performative, që i përkasin trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe çdo performancë është një përgjigje ndaj thirrjes së pasurisë kulturore të vendit.

Ky festival thekson se trashëgimia kulturore e Kosovës është një thesar që duhet ruajtur dhe bartur nëpërmjet brezave. Kësaj i bashkohet edhe dëshira që ky festival të shpallet trashëgimi e njerëzimit në UNESCO.

Profesorët dhe studentët e Departamentit të Antropologjisë janë mysafirë të përhershëm të festivalit “Hasi Jehon”. Në vitin tjetër, profesor Canolli, do të jetë në grupin përzgjedhës të performancave në festival.



Foto nga Festa e Buzmit, Zym, Kosovë

Festa e Buzmit

Kjo festë mbahet gjithandej te popujt e Evropës sikur edhe te shqiptarët. Këtë herë më 21 dhjetor 2022 ansambli "Katarina Josipi" e nxori në skenë si performancë të veçantë, ndonëse e kanë performuar shkurt edhe nëpër festivale folklorike të kaluara. Një synim ky për inskenimin performativ të një praktike rituale parakrishtere e ruajtur te shqiptarët.

Për 'buzmin' kanë shkruar antropologët si James Frazer te "Golden Bough" (Dega e artë) ("Yule" / "Midwinter festival") ndërsa për këtë rit kanë shkruar edhe Mark Krasniqi, Mark Tirta, Ukë Xhemaj, e të tjerë.

Nën udhëheqjen e profesor Arsim Canollit, studentë të Departamentit të Antropologjisë dhe Sociologjisë morën pjesë dhe vëzhguan nga afër një inskenim të ritit të buzmit, që festohet tradicionalisht në Zym. Ky rit magjik është bartur deri më sot përmes krishterimit, por rrënjët i ka në kulturën pagane, si rit i pjellorisë dhe bimësisë. Një dru vishkull qarri pritët në mal dhe sillet në shtëpi - ushqehet me ushqime dhe vendoset në zjarr. Hiri i tij hidhet në ara për të shtuar të mirat e bujqësisë. Këndohen këngë, shprehen urata, shtrohet sofa e gostiten familjarët, antropomorfizohen bimët e shumë gjëra të tjera. Gjithë synimi është te knellja e diellit sepse kjo është nata më e gjatë e vitit dhe thirret kthimi sa më i shpejtë i diellit.

Riti përcillet nga të kënduarit e fjalëve:

Po vjen buzmi bujar

Me gjethe e me bar

Me edha e me shtjerra

Mas tyre vjen vera

Ky rit duhet të studiohet në kontekst të trashëgimit të një praktike rituale, ndryshimeve në familje, migrimit, kulturës si relik e kulturës mimetike, religjionit, politikave kulturore, turistifikimit, etj. Por mbi të gjitha, si pjesë të diversitetit kulturor në log të identitetit shqiptar.

- Arsim Canolli



Foto nga Festa e Buzmit, Zym, Kosovë

Falënderojmë familjen Kolgjeraj, zymjanët e hasjanët, që na ftuan dhe ofruan një mikpritje të këndshme dhe të paharruar!



Foto terreni nga Janet Raincek, vitet e 80-ta, Rogovë, Has Kosovë



Në fillim të muajit korrik të vitit 2023 u mbajt edicioni i parë i Shkollës Verore Antropologjike, e organizuar nga Departamenti i Antropologjisë. Këtë vit, 10 studentë morën pjesë në këtë shkollë nën ndihmën dhe mbikëqyrjen e 3 profesorëve të departamentit.

SHVA 2023 është një projekt i mbështetur nga Universiteti i Prishtinës dhe synon të kontribuojë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në rrezik. Tema e këtij edicioni ishte “Trashëgimia kulturore në rrezik”. Kjo shkollë përfshiu shqyrtimin e disa aspekteve të rëndësishme të kësaj teme. Në fillim, u diskutua rreth sfidave të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike, me një fokus të veçantë në lokalitetin “Kalaja e Pogragjës” në

Gjilan, me ligjërata, punëtori dhe diskutime me Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari. Më pas, u trajtuan sfidat dhe mundësitë e ruajtjes së trashëgimisë shpirtërore, duke u përqëndruar te tradita e veshjeve hasjane në Zym, Has me Prof. Asoc. Dr. Arsim Canolli. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i trajtuar në këtë edicion shënjes ishte dhe menaxhimi i fondeve muzeore, me theks të veçantë te ruajtja e artefakteve në Muzeun Kombëtar të Kosovës në Prishtinë, punëtori kjo e drejtuar nga Prof. Ass. Dr. Zanita Halimi.

Dita 1, “Shkolla Verore e Antropologjisë filloi me punëtorinë e parë në kalanë e Pogragjës, në

rrethinën e Gjilanit. Profesori Arben Hadari, mbajti një ligjëratë hyrëse dhe njoftuese për historinë e kalasë, prej parahistorisë deri në antikitetin e vonë. U dokumentua gjendja e kalasë, u identifikuan rreziqet potenciale, u mbledhën intervista me vendës për raportin e tyre me kalanë, për legjendat e gojëdhënat, u vlerësua potenciali për rivitalizim dhe efektin në turizëm e shumë të tjera. Po ashtu, u gjet edhe një vegë e një ene, që u konsiderua e hekurit të hershëm. Pra, në një kala që duket se ka bartur evidenca të jetës prej hekurit të hershëm (1100-900 para Krishtit). Studentët patën mundësi të diskutonjë, të pyesin, të mbledhin evidenca për një “njohje bazike të rrezikut” që i kanoset kalasë dhe një

vlerësim të potencialit të saj rivitalizues për zonën! “Kemi shumë trashëgimi kulturore, vetëm duhet me ua fshi pluhurin pak dhe me i nxjerr në pah”, kështu u shpreh Samir Aliu, pronar i kafenesë dhe ZipLine “Green” afër kalasë së Pogragjës, që ka shndërruar Pogragjën në destinacion të ri të turizmit ditor në Kosovë.”

- Arsim Canolli

Dita 2, “Studentët e Shkollës Verore të Antropologjisë vazhduan punën e dokumentimit të trashëgimisë kulturore në rrezik, gjegjësisht dokumentimin e koleksionit privat të Lajde Kolgjerajt në Zym të Hasit. Prej çfarë rrezikohet veshja hasjane? Prej



Foto nga Shkolla Verore

shumë faktorëve, mungesës së vekatoreve, mungesës së lëndës së parë, ndryshimit të yrrneqeve, komercializimit të tepërt, mungesës së dijës profesionale për trajtimin dhe mirëmbajtjen e veshjeve e faktorëve të tjerë. Lajde Kolgjeraj ka një koleksion të veçantë të veshjeve, të cilat i ka mbledhur ndër vite nga Zymi dhe fshatrat përreth. Koleksioni ka afër 1000 njësi. Me përkrahjen institucionale, ky koleksion do të bëhet muzeu më unik në Kosovë, i cili nëpërmjet veshjeve do të pasqyrojë denjësisht kulturën ndërbreznore të ruajtur në regjionin e Hasit. Veshja e Zymit të Hasit është e mishëruar në jetën ceremoniale të familjes hasjane. Por, ndryshimet e mëdha ekonomike, sociale e kulturore kanë afektuar edhe këtë veshje. Andaj, ruajtja dhe promovimi i kësaj veshje është me shumë rëndësi dhe prioritet. Studentët e Shkollës Verore të Antropologjisë sivjet ndihmuan në këtë drejtim, duke inventarizuar një pjesë të këtij koleksioni.”

- Miridonë Sylja dhe Olisa Çekaj

Dita 3, “Sot përfunduar ditën e tretë të Shkollës Verore Antropologjike, në kuadër të së cilës zhvilluam puntorinë me temën “Trashëgimia kulturore në rrezik: trajtimi i ekspozitave të arkeologjisë, të tekstit dhe të drurit”. Punëtorja u zhvillua në Muzeun Kombëtar të Kosovës dhe Muzeun Etnologjik. U identifikuan rreziqet, si ato të brendshme, ashtu edhe ato të jashtme dhe, u theksuan masat preventive për fondet apo koleksionet që mban ky Muze. Pa dyshim, gjendja e koleksioneve në Muzeun e Kosovës nuk është më e mira, për arsye të shtresimit të rreziqeve



Foto nga Shkolla Verore

me dekada, si atyre infrastrukturore ashtu edhe atyre të natyrave të tjera. Mendojmë se, punëtorja e mbajtur në Muzeun e Kosovës nga studentët, promovon bashkëpunimin midis institucioneve arsimore dhe institucioneve kulturore. Ne patëm mundësi të shohim nga afër se çfarë rreziku u kanoset koleksioneve dhe identifikuam disa nga mënyrat se si mund të eliminohet ky rrezik. Shkolla Verore e Antropologjisë kontribuon në sensibilizimi e publikut për trashëgiminë kulturore të Kosovës. Falënderojmë stafin e Muzeut Kombëtar të Kosovës dhe Muzeut Etnologjik që na ofruan qasje në koleksionet e tyre të veçanta!”

-Gresa Marmullaku

Shkolla Verore e Antropologjisë përfundoi me prezentimet e studentëve pjesëmarrës, në grupe, për punën e tyre, duke diskutuar gjerësisht për rreziqet e trashëgimisë kulturore.

10 studentë të Shkollës Verore të Antropologjisë 2023, morën certifikatat e pjesëmarrjes dhe punës së bazuar në projekt me temën “Trashëgimia kulturore në rrezik” (3-7 korrik 2023).

Përshtypjet e studentëve për SHVA 2023



Foto nga Shkolla Verore

“Jam shumë e lumtur që kam qenë pjesë e kësaj shkolle sepse më ka dhënë një energji shumë të mirë, shumë dije. Kam provuar vetën në këto aktivitete duke u frymëzuar që të vazhdojë dhe më tutje në këto drejtime që realisht ndihmojnë shumë ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Për këtë shkollë verore meritë të madhe kanë padyshim udhëheqësit e saj që janë tre profesorët që ishin shumë të përkushtuar, duke na motivuar dhe përkrahur..”

- Arbesa Berisha

“Shkolla Verore Antropologjike 2023, për mua ka qenë njëra ndër eksperiencat më të bukura që kam kaluar gjatë 3 viteve studime, po ashtu shumë efektive për njohjen më afër se çfarë mund të sjell terreni gjatë rrugës. Njohja me veshjet hasjane dhe mësimi për ruajtjen e eksponateve të cilat konsiderohen më në rrezik ndikuan në përforsimin e njohurive të mia. Shkolla Verore Antropologjike ka qenë shumë efektive dhe praktike; shpresoj të mbahet edhe në vitet në vijim.”

-Gresa Marmullaku



Foto nga Shkolla Verore

“Shkolla Verore e Antropologjisë më mundësoi të prek vatrat ku lind dhe ndodh kultura, edhe kur ndonjëherë kujtojmë se është shuar. Aty kisha mundësinë të shoh, të ndjej vlerën, dinjitetin e respektin për to dhe për ata që i ruajnë, i mbrojnë dhe i kultivojnë. Inspiruese për vazhdim të studimeve.”

-Afrim Visoka



Foto nga Shkolla Verore



Foto nga "Ulpiana Fest", shkrepur nga Andi Mullazenuni



“Ulpiana Fest” - Festa e arkeologjisë së Kosovës, Dardanisë Antike

Foto nga “Ulpiana Fest”, shkrepur nga Andi Mullazeni

Pas një vere të frytshme nga gërmimet arkeologjike në Ulpianë, ku është gjetur një prej mbishkrimeve dedikuese të Justinianit për qytetin dardan, u organizua një festival si dedikim për punën, bashkëpunimin dhe edukimin arkeologjik. Studentët dhe mësime të Departamentit të Antropologjisë organizuan festivalin arkeologjik ULPIANA FEST, që u mbajt më 16 dhe 17 shtator 2023, në parkun arkeologjik të Ulpianës.

Për dy ditë radhazi, Ulpiana e Dardanisë Antike u shndërrua në një vend feste për arkeologjinë dhe trashëgiminë kulturore. Festivali arkeologjik ULPIANA FEST u bë skenë e një ahengu e shkolle të arkeologjisë, duke shfaqur copëza të antikitetit dardan e romak. Përmes rikonstruktimit të lojërave, recetave të hajeve dhe veshjeve antike, përmes shfaqjes së monedhave antike, valleve, muzikës, poçarisë dhe elementeve të tjera, u dha një skenë e antikitetit të Ulpianës e Dardanisë antike.

Në natën e parë, në ora 18.00, filloi programi i festivalit, ku pati edhe disa elemente specifike. Programi përshëndetet nga organizatorët, Rilinda Gjonbalaj dhe Ilir Culaj. Rilinda Gjonbalaj tha “Ulpiana sot është nikoqire e edicionit të parë të këtij festivali e që shpresoj se do të kthehet në një traditë të gjatë për të promovuar e vënë në pah trashëgiminë kulturore. Më lejoni që të shpreh falënderimet dhe mirënjohjen time më të sinqertë për të gjithë ata që dhanë kontributin e tyre që ky festival të realizohet, duke mos e kursyer aspak vetën e tyre dhe për këtë më meritoret janë profesorët e çmuar të Departamentit të Antropologjisë Prof. Arsim Canolli, Prof. Tahir Latifi dhe gjithë të tjerët, që me profesionalizmin e tyre i dhanë ngjyra shumë më të mira këtij organizimi.” Duke evokuar jetën sociale të dardanëve dhe romakëve, Ilir Culaj tha “Të mendojmë për një moment se, kushedi sa festa, gëzime, vuajtje apo tragjedi kanë ndodhur brenda mureve antike të këtij qyteti ku ne jemi sonte. Kushedi se çfarë shfaqje kanë interpretuar aktorët në teatrin e Ulpianës dhe, sa shumë publiku i duartrokiste ata dikur. Prandaj, sonte, në këtë ditë të shenjtë për Ulpianën, jemi munduar t'i rikujtojmë banorët e këtij qyteti dhe përditshmërinë e tyre. Pse jo, të flasim për djathin dardan, të cilin e përmend autori romak Varroni në volumnin e dytë të librit të tij mbi agrikulturën. Apo, të kujtojmë një pasazh të Strabonit, i cili duke folur për dardanët dhe muzikën ndër të tjera thotë: ...muzikën nuk e lënë mënjane, por përkundrazi përdorin gjithmonë fyej e vegla me kordha. Autorët tjerë na shpjegojnë për pijet prej



Foto nga "Ulpiana Fest"

mjalit tek ilirët apo berrën e tyre që e quanin sabaum apo sabaia."

U dhanë mirënjohje për tre udhëheqësit e projektit arkeologjik të Ulpianës, Prof. Arben Hajdarin, Prof. Christophe Goddard dhe doktorantin Milot Berisha. Mirënjohjet indanë pjesëmarrësitenderit, ambasadori amerikan, z. Jeff Hovenier, ambasadori francez, z. Olivier Guérot dhe zëvendës përfaqësuesja e BE-së në Kosovë, znj. Eva Palatova. Mirënjohjet u dhanë për "punën konsistente shumëvjeçare në gërmimin arkeologjik në Ulpianë, avancimin e edukimit arkeologjik për gjeneratat e reja, bashkëpunimin e

frytshëm arkeologjik ndërkombëtar dhe kujdesin dhe profesionalizmin për arkeologjinë në komunitet dhe për publikun".

Profesori Goddard falënderoi organizatorët dhe theksoi se ishte i lumtur që ishte në mes të Ulpianës antike dhe falënderoi gjithë ekipin hulumtues të projektit, për të cilët theksoi se "janë të gjithë meritore". Ai, po ashtu, falënderoi të gjithë paraardhësit që kanë punuar në Ulpianë. Ai theksoi: "Si Roma e Ulpiana, ashtu edhe Brukseli e Prishtina, sot janë një familje: familja evropiane." Ai falënderoi BE-në për financimin e projektit, që sivjet solli rezultate të jashtëzakonshme,



Foto nga "Ulpiana Fest"

pas shumë vitesh pune intensive. Edhe profesori Arben Hajdari dhe Milot Berisha falënderuan organizatorët dhe gjithë kolegët e tyre për punën e realizuar në Ulpianë.

Programi vazhdoi me këngë e valle të vjetra, nga grupi i Lezhës së Shqipërisë, ku u shqua rikonstruktimi i gjamës së burrave. Po ashtu, programi vazhdoi me premierën e dramës "Justiniani dhe Teodora", e cila u luajt në ambient të hapur pranë mureve të qytetit antik, në prani të një numri të madh pjesëmarrësish. Drama u shkrua nga Arian Krasniqi, me regji të Kushtrim Mehmetit e në aktrim të studentëve të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës.



Foto nga "Ulpiana Fest"

Në ditën e dytë, prej orë 13.00, festivali filloi të vizitohet nga një numër i madh vizitorësh, kryesisht familjarë me fëmijët e tyre, por edhe vizitorë enkas nga fusha e trashëgimisë kulturore. U luajtën lojëra, u pikturuan pamjet e Ulpianës, e u demonstrua poçaria. Në orën 18.00, filloi programi me ansamblin e Çegranit të Maqedonisë së Veriut, ku u veçua riti i thirrjes së bletës, një rit i vjetër pagan. Pastaj, një numër studentësh të veshur me kostume antike, dardane e romake, por edhe me kostume të cilat kanë mbijetuar që nga lashtësia, si xhubleta e Malësisë, veshja e grave të Hasit dhe Anamedvegjës (Gollakut) e veshje të tjera sfiluan në skenën e festivalit. Për fund u dha edhe repriza e shfaqjes teatrale "Justiniani e Teodora", në prani të një numri të madh pjesëmarrësish, përfshirë kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, ministrin e kulturës, z. Hajrulla Çeku, ministren e industrisë, znj. Rozeta Hajdari dhe një numër deputetësh, e akademikë.



Foto nga "Ulpiana Fest"

Kosova turistike: Janet Reineck dhe etno-turistët amerikanë

Nisur në një udhëtim të eksplorimit kulturor të disa viseve të Kosovës, Janet Reineck, një antropologe e pasionuar ndaj kulturës shqiptare, udhëhoqi një grup prej njëmbëdhjetë amerikanësh në një udhëtim të paharrueshëm etnoturistik në Kosovë. Ky "ethno-tour" u zhvillua nga 18 korriku deri më 28 korrik 2023, duke vizituar vende si Prizreni, Gjakova, Peja, Gryka e Rugovës dhe Opoja. Me plotë dhjetë ditë të ngjeshura, me përjetime kulturore të ndryshme, nga shijimi i ushqimeve tradicionale e deri tek këngët dhe vallet e zonave të vizituara. Janet Reineck me asistencë të studentes së Departamentit tonë, Arlinda Shatrit, mundësuan që ky grup të përjetojë vizitën në Kosovë si kurrë më parë.

Ulpiana Fest ka lënë një shenjë të pashlyeshme në peizazhin kulturor të Kosovës, duke shërbyer si një dëshmi e përkushtimit për të ruajtur dhe festuar trashëgiminë e Kosovës. Përmes frymës bashkëpunuese të organizatorëve të saj, mbështetjes së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe pjesëmarrjes entuziaste të publikut, Ulpiana Fest premton të bëhet një ngjarje themelore në kalendarin kulturor të Kosovës, duke siguruar që tingujt e së kaluarës të vazhdojnë të rezonojnë me brezat e ardhshëm.



Rilinda Gjonbalaj dhe Ilir Culaj, shkrepur nga Andi Mullazeni





Ja rrëfimi i saj:

"Fillimi i një "Ethno Tour" në Kosovë me antropologen Janet Reineck më ka dhënë një mundësi të pashembullt për t'u zhytur në tapiceri të pasur të vendeve të bukura, historisë së vendit dhe njerëzve të tij. Këtë eksperiencë e pasuron edhe më shumë prania e 11 vizitorëve amerikanë të cilët kanë një perspektivë unike të rrugëtimit. Këta nga zona dhe profilizime të ndryshme, por me një dëshirë të madhe për të njohur kulturën shqiptare. Ata i njihnin shumë mirë vallet tona dhe të gjithë u befasuam me hapat e tyre nën tingujt e lodrave të Opojës. Nga ngrohtësia dhe mikpritja e vërtetë e popullit të Kosovës e deri te kultura thellë e rrënjës, udhëtimi jo vetëm që pikturoi një pamje të gjallë të së kaluarës së vendit, por gjithashtu theksoi shpirtin e qëndrueshëm të popullit të tij.



Jo vetëm unë, por i gjithë grupi u mahnitëm nga mikpritja që është ende prezente në bjeshkët e Opojës e deri tek ato të Rugovës, e përcjellë njëashtu edhe nga ndershmëria dhe sinqeriteti që rrezatonin banorët e saj. Takimi ynë me qytetarët e Opojës në fillim të "Ethno Tour" dhe veçanërisht takimi i znj. Janet Reineck me familjet ku ajo jetonte në vitet e '80 deri '90-tat ishte mjaft mbresëlënëse dhe rezultoi në diskutim të thukët. Ky bashkim i narrativave personale e deri tek diferencimet në kulturën tonë dhe atë amerikane, e ka bërë të gjithë udhëtimin tonë më të bukur.

Gjatë udhëtimit, populli i Kosovës na priti krahëhapur. Mikpritja e tyre pasqyrohet vërtetë në çdo buzëqeshje, gjest dhe bisedë të përzemërt që kemi ndarë. Qoftë një takim i rastësishëm me një artizan vendës, apo një diskutim i sinqertë me një familje në një fshat rural, ngrohtësia e tyre ishte gjithmonë e pranishme. Kjo mirëseardhje solli në jetë shprehjen e vjetër të mikpritjes, si një gurthemel në kulturën tonë.

Në Kuqishtë të Rugovës, aty u njohja me familjen e zonjës Dushe Gjevukaj, ku krijuam një miqësi të fortë. Në rrugët ku ecja rreth hambarit të shtëpisë 100 vjeçare, mu zgjua një dëshirë për t'u ngjitur mal pas mali. Ecja nëpër male dhe ngjitja në Liqenatin e Rugovës ishte e përcjellë nga një kënaqësi kolektive dhe një qetësi shpirtërore.

Një nga aspektet më prekëse gjatë udhëtimit ishte mirënjohja dhe respekti i treguar ndaj vizitorëve amerikanë. Përmes bisedave dhe anekdotave me banorë të ndryshëm, u kuptua se në zemrat e tyre kishte një vend të veçantë për ndihmën që dhanë

amerikanët gjatë luftës. Në çdo dasmë që merrnim pjesë, kishte një flamur amerikan. Bujaria e shpirtit e shtrirë ndaj tyre, si amerikanë, ishte zemërgjerë. Komplimentet dhe shprehjet nuk ishin vetëm për disa, por ishte një njohje kolektive e lidhjeve të krijuara nga këto të përbashkëta.

Ndërsa po përshkonim peizazhet befasuese të Kosovës, ato dukej që ishin konstante historike dhe triumfale të përjetimeve të banorëve. Plagët e luftës janë përballur në bukurinë mahnitëse të vendit; ato janë dëshmi e shpirtit të paepur të popullit të tij. Narrativa e tregimeve të dhimbjeve nënvizonte vendosmërinë për të rindërtuar, edhe grimcat e tyre jepnin shumë ide tek vizitorët amerikan se si në Kosovë një popull kaq i vogël mund të jetë kaq ndryshe nga një vend në tjetrin.

"Ethno Tour" na lejoji të dëshmojmë përmbajtjen e traditave që përcaktojnë hartëzimin kulturor të Kosovës. Nga muzika dhe vallëzimi tradicional e deri te punimet artizanale, çdo aspekt i kulturës ishte një dëshmi e krenarisë së rrënjës dhe të përbashkët. Pikëpamja e Janet Reineck pas kthimit të saj në zonat e vjetra, ku kishte qëndruar para luftës në Kosovë dhe kontekstet e reja të disa zakoneve, bënë të gjitha kuptimet tona karshi kulturës të rëndësishme dhe evolucionare me kalimin e kohës.

Si përfundim, "Ethno Tour" në Kosovë ishte një rrugëtim vetë-zbulimi për të gjithë. Ky udhëtim nuk ishte vetëm për të gjurmuar një tokë të huaj nga vizitorët amerikanë dhe nga një vendëse si unë; kishte të bënte me përqaftimin e një njeriu të zakonshëm. Ndërsa reflektoj mbi udhëtimin, më kujtohet se është e vërtetë që një vend nuk është i bukur vetëm në peizazhet e tij, por në zemrat e njerëzve të tij - historitë e tyre, qëndrueshmëria e tyre dhe kapacitetet e tyre të pakufishme për ngrohtësi dhe mikpritje."

- Arlinda Shatri



Xhubleta në UNESCO



UNESCO ka krijuar dhe mirëmban konventën për ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore. E ratifikuar në vitin 2003, kjo konventë përfshin ngritjen e vetëdijes për trashëgimi kulturore shpirtërore në nivel ndërkombëtar, sidomos për atë që hyn në lista të ruajtjes nga UNESCO. Definimi i trashëgimisë kulturore sipas kësaj konvente përfshin praktikën, shprehjet, dijet, njohjen dhe vlerësimin e kulturës materiale dhe shpirtërore. Çfarë kulmon njohjen e një trashëgimie kulturore nga UNESCO është dokumentimi, identifikimi, hulumtimi konstant, ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i çështjeve dhe faktorëve të ndryshëm që kanë të bëjnë me të. E rëndësishme është se, përmes kësaj arrihet edukimi formal dhe jo formal mbi trashëgiminë kulturore shpirtërore dhe materiale.

Më 29 nëntor të vitit 2022 xhubleta hyri nën mbrojtje të UNESCO-s. Veshja e xhubletës bëhet përmes një mjeshtërie tradicionale nga gratë; xhubleta punohej dhe vishej nga gratë e viseve malore të Shqipërisë së Veriut, Malit të Zi dhe Kosovës. Procesi i krijimit të një xhublete kërkon aftësi, përpikëri dhe shumë durim e kohë. Xhubleta e cila peshon rreth 15kg, qepet me rripa prej shajaku që bashkohen përmes gajtanëve të hollë prej leshit dhe të cilat vendosen në një linjë horizontale. Kjo veshje monumentale, e cila kujtudo që e vesh i jep fuqi, ka një pamje madhështore dhe hijerëndë. Ajo shoqërohet edhe me pjesë tjera shajaku të zi, brezit të zbukuruar me rruaza dhe gajtanë, paraniku dhe prapaniku, si dhe paftat e punuara nga filigrani dhe aksesori të tjerë. Realizimi i veshjes së xhubletës testohet dhe performohet duke u testuar se si qëndron në këmbë. Xhubleta na jepet me forma të valëzuara në formë të këmbanës. Përderisa është veshur në vise malore, figurativisht njashtu si malet që janë të valëzuara vjen edhe inspirimi imitues i formës së saj.

Xhubleta jashtë muzeut, në ambiente të gjalla, tani vishet vetëm në raste festive. Si çdo veshje tjetër, ajo është një lloj identifikimi, komunikimi dhe marrëdhënie simbolesh. Xhubleta e bardhë është veshur nga vajzat, e kuqja e mbushur me ornamente është veshur nga gratë e martuara, kurse e zeza është veshur nga gratë e moshuara. Ornamentika përbrenda xhubletës pasqyron gjendjet emocionale shpirtërore. Veshja ngërthen simbole të dukshme dhe të padukshme, e këto përçojnë vizion, emocion dhe komunikojnë me njëra tjetrën. Xhubletat kanë pasur attribute jo vetëm në dukje por edhe në mesazhet që kanë bartur. Tipologjia e xhubletës ndahet në Malësinë e Madhe dhe në pjesën e Dukagjinit. Në Malësinë e Madhe fundi i xhubletës është i bardhë dhe është aq e madhe saqë duke ecur në të mund të prekësh tokën. Ajo ndryshe nga pjesa e Dukagjinit posedon më shumë aksesori dhe ornamente. Veshja e xhubletës rreth 4000 vite e vjetër, përmban besim kultik dhe magjik. Simbolet nga format gjeometrike, gjarpri, shqiponja, dielli e hëna komunikojnë me lashtësinë dhe mjeshtërinë e grave që i krijuan ato.

Hyrja e xhubletës në UNESCO është vetëm hapi parë i një njohje ndërkombëtare të mëtutjeshme. Përgatitja e dosjes për UNESCO kërkon hulumtim

dhe dokumentim për të përmbushur secilën prej komponentëve për të ditur origjinën dhe bartësit. Kategoria e trashëgimisë kulturore shpirtërore ndahet në disa lista. Ndërto to, lista reprezentative, lista urgjente dhe aktivitetet të cilat promovojnë trashëgiminë kulturore. Xhubleta hyn në kategorinë e trashëgimisë kulturore në rrezik. Kjo për shkak se nga shqyrtimi i këshillit të përgjithshëm të UNESCO-s, veshja ka shumë pak bartës. Ka fare pak gra që veshin dhe zotërojnë këtë mjeshtëri dhe, për këtë arsye ajo është cilësuar në rrezikshmëri të zhdukjes për tu trashëguar. Etnografja Afërdita Onuzi rrëfen historinë e kësaj veshje në studimin e saj rreth 50 vjeçar në Alpe

të Shqipërisë. Ajo përmbledh veçantitë, misteret e ornamenteve dhe gjithçka tjetër për veshjen në librin "Xhubleta" të botuar në vitin 2022. Përmes këtij libri, bën thirrje që themelet e veshjes të mos cenohen nga riprodhuesit. Esenca e trashëgimisë kulturore është se ajo gjallërohet përmes njerëzve, dhe nëse njerëzit nuk janë ata që i transmetojnë këto praktika, ato bëhen të vështira për t'u ruajtur. Për këtë arsye, përmes UNESCO-s krijohen fonde që ndihmojnë në dije-përcjellje, dhe ato gra që zotërojnë këtë mjeshtëri mund të edukojnë dhe mësojnë gjeneratat që vijnë pas tyre.



Edith Durham për Dardaninë

Dardania dhe disa emra vendesh në Ballkan nga Edith Durham (Ky artikull është botuar në mars të vitit 1923 në revistën antropologjike *Man*, Vol. 23. Për arsye referencash dhe për arsye të kontekstit antropologjik – linguistik, emrat e vendeve janë lënë në origjinal.)

Në rajonet shqiptare dhe në ato të sllavëve të jugut, një numër i madh i emrave të vendeve derivon prej emrave të bimëve. Njerëzit u vendosën në vende pjellore dhe i emëruan ato prej bimëve që u rritën aty. Në të gjitha rrethinat ku flitet serbisht kam hasur në emra siç është Grahovo (vend i fasuleve), Orahova (i arrave), Jagodina (i dredhëzave të egra), Treshnja ose Treshnjevo (i qershiave), Jabuka (i mollave), Krushevo ose Krushevatz (i dardhave), Vrbiza (i shelgjeve), Bukovina (i ahut) dhe shumë të tjerë janë të rëndomtë. Ngjashëm në Shqipëri gjejmë emrat Arnje (bredha, pisha), Kashtenja (gështenjat), Mela (mollë), Arra (arrë), Chereti (dushk), Kumula (kumbulla), Dardhe (dardha) dhe të tjerë të gjitha duke u shfaqur si emra vendesh. Të gjithë lisat dhe bimët e lartpërmendura njihen si karakteristika vendore të Evropës Juglindore, aq sa unë mund të mësoj dhe është më se e sigurt se janë rritur e shtuar kadalldale në të njëjtat vende, të cilat kanë mundur të jenë të pushtuara prej Lekës së Madh, Justinianit, Abdul Hamidit apo Petar Karagjorgjeviçit. Kështu që, mund të gjejmë se disa prej këtyre emra vendesh kanë origjinë antike. Kur dëgjojmë për Ballkanin së pari dimë se ka qenë i banuar prej shume fiseve me prijësa të pavarur, mirëpo (aq sa informatat tona na lejojnë) shumica e tyre kane folur një gjuhë të ngjashme dhe kishin zakone të ngjashme. Një prej fiseve të rëndësishme ishin dardanët. Për dardanët mësojmë prej autorëve të ndryshëm klasikë se ishin fis i fuqishëm ilir, që zinin pozitë të rëndësishme strategjike. Territorët e tyre shtriheshin në mes luginave të Moravës dhe të Vardarit dhe përgjatë Drinit. Kështu që ata i komandonin udhët për në Danub, Adriatik dhe Egje. Ata shqetësonin maqedonët. Livi jep një sqarim mjaft detajues për luftërat e tyre me Filipin, mbretin e fundit të Maqedonisë me këtë emër (vdiq më 179 para Krishtit). Ishte ai i cili duke provokuar luftë me

Romën e solli shkatërrimin e Maqedonisë (Livi, lib. XXXI, c.5). Filipi pasi përgatiti një ushtri që të luftojë romakët “ndërmori papritmas një ekspeditë në territoret e Orikumit dhe Apollonisë (Shqipëria e Jugut) në mënyrë që Maqedonia të mos ngacmohej prej ilirëve dhe qyteteve që i kufizonin përmbi, me pasoja terrorin që synonte mbi ta. Pas shkatërrimit të pjesëve përbrinjëse të Ilirisë ai... mori Sintian, një qytet idardanëve, që dotu jepte udhëkalim përnë Maqedoni.

Rezultat i kësaj ishte se përderisa Filipi ishte duke luftuar romakët “ai u përball me lajmëtarë që posedonin informata për rrëmuja ende më të mëdha, se dardanët pasi kishin kaluar në Maqedoni kishin në duar Orestisin dhe kishin zbarkuar në fushën e Argesteanit”. Lajmi i vdekjes së Filipit inkurajoi dardanët për këtë sulm. Kështu që, Dardanët (Lib XXI, 28) duke parë se romakët ishin fitues, erdhën, me “disa mbretër të vegjël dhe disa princa, fqinj të maqedonëve, dhe u ofruan ndihmë romakëve kundër Maqedonisë. Konsulli ishte marrë vesh se do të përdorte ndihmën ...e dardanëve kur herën tjetër ta drejtonte ushtrinë e tij për në Maqedoni.” Në librin XL, c. 57 gjejmë Filipin të zemëruar, duke planifikuar t’i shfaros dardanët dhe t’i vendosë “bastarnët në tokat e tyre, kështu që, të rrjedhë një përparësi e dyfishtë.” Dardanët si armiq do të eliminoreshin dhe bastarnët do të mund të përdoreshin për ta rrënuar Italinë. Edhe po të shpartalloheshin bastarnët prej romakëve do t’ia vlente “të fitohej trofeja dhe pushtimi i tërësishëm i Dardanisë do të arsyetohej si ngushëllim.” Mirëpo, një shpërthim i jashtëzakonshëm i shpërndau bastarnët dhe Filipin vdiq. Më shumë nuk gjejmë për dardanët te Livi. Mirëpo, është e evidente se ata ishin një popull i pasur dhe i fuqishëm. Siç është e vërtetë për gjithë ballkanasit, ata u lidhën me pushtuesin e huaj kundër fqinjëve të tyre dhe më pas e jetuan pendimin. Në kohën e Strabos (ob. A.D. 25) ata



Fig 1. Harta e Ptolemeut që tregon Dardaninë

thyhen plotësisht e bien nën sundimin romak. Ai përshkruan se si romakët shtynë fiset e pabindura drejt maleve të cilat ishin “të papërshtatshme për bujqësi.” “Popujt që më herët ishin shumë të fuqishëm janë të paktë ose janë reduktuar në pozita më të ulëta; siç janë Boii dhe Scordisci në mes të Galatae dhe Antariatae, Ardaei dhe Dardani në mes të Ilirëve....Ata në fillim u keqësuan për shkak të konflikteve në mes veti (ajo që zakonisht rrënon fiset, popujt fisnor) dhe më në fund u raskapitën nga luftërat me Maqedoninë dhe me romakët.”

Ai e përshkruan denjësisht situatën e dardanëve. “Lumi Drilon (Drin) mund të navigohet deri në Dardanica. Ky vend shtrihet afër popujve maqedon dhe paeonian ...dardanëve u përkasin edhe Galabrii...dhe Thuniatae, të cilët i afrohen në lindje Maesi, fis trakas... Dardanët janë njerëz krejtësisht të egër, sa që mihin shpella nën togje plehu në të cilat banojnë. Mirëpo ata duan shumë muzikën dhe luajnë me gajde dhe me instrumente me tela. Ata i banojnë pjesët e brendshme të vendit dhe ne do t’i përmendim njëherë tjetër.” (Strabo, lib VII.et seq.). Por për fat të keq të tjerat janë humbur. Dardanët në kohën e Strabos ishin në gjendje të mjerueshme. Ata fuqishëm më kujtojnë bullgarët e djegur të Maqedonisë më 1904. Vazhdimisht i kam gjetur grupe grash të ngjethura me kambe të djegura e të groposura gjer në kofshe në grumbull plehu me shprese se do të gjejnë pak ngrohtësi. Ato ishin gjysmë lakuriqe, pa kulm dhe të pambrojtura nga era e thatë. Të tjerat të grumbulluara në ahrije, nëse mund të gjendeshin diku. Dardanët pasi që ishin të mposhtur nga romakët kanë qenë padyshim në të njëjtën pozitë. Dhe si fshatarët e tanishëm ballkanas




Fig 2. Skicë që tregon emra modern të emëruar sipas dardhave

në rast mizorie të ashpër afroheshin rreth njërit prej tyre që këndonte për të kaluarën e tyre heroike. Plus ça change c'est la même chose! Dardanët s'do të mund të kishin pasur instrument me tela më primitiv sesa lahuta që ende i bihet në vendet tyre të mëhershme.

Hartat e Ptolemeut (rreth 140 pas Krishtit) këtu japin pozitën e Dardanisë. Skica shoqëruese (fig.1) prej botimit të Ptolemeut nga Margini, më 1621, edhe pse pas shumë shtrembërimeve jep një ide mjaft të qartë dhe tregon se është zgjeruar në veri të Nishit. Më vonë në kohën e Dioklecianit (313 pas Krishtit) Dardania bëhet provincë romake me Naissus si kryeqytet. Diokleciani ishte prej gjaku ilir, fakt ky i cili mund ta ketë shtyrë që ta mbaj emrin ilir. Emri është shuar tash në kohët e fundit. Dardania gjendet në formë trekëndëshi në hartën që e posedoj të vitit 1610, “prej John Speed, të shitur prej Roger Rea në Cornhill.” Përfshin Nishin dhe Shkupin. Dhe “Dardaniae Deserta” është e shkruar përgjatë një copë toke që shtrihet mu në midis të gadishullit në hartën e publikuar në “Norimberga 1770”. A kanë lënë ndonjë gjurmë dardanët në tokën e sotme? Nëse, siç sugjeroj unë, ne mund ta nxjerrim emrin Dardania prej një fjale ilire që do të thotë “dardhë”, fjalë e njëjtë me fjalën e sotme shqipe “dardhë”, atëherë me siguri se kanë lënë gjurmë. Ekzistojnë tri Dardha në Malësi afër Drinit, i cili në ditët e Strabos ishte i navigueshëm (i lundrueshëm) deri në Dardani. Unë besoj se kjo pjesë e vendit duke qenë malore ka qenë vazhdimisht e banuar me njerëz të gjakut shqiptar (gjegjësisht ilir) dhe ka qenë vazhdimisht shqipfolëse. Fushat prapa Drinit ranë tërësisht nën sundimin serb për një kohë të gjatë dhe tash është rikthyer prapë nën Serbi. Këtu po ashtu ka shumë




Fig 3. Model dardhe në Mal të Zi




Fig 4. Model dardhe ne Bosnjë

emra dardhash, mirëpo janë serbizuar si p.sh. Krushevo dhe Krushevatz. Harta shoqëruese(fig.2) i jep ato kryesoret të cilat bien brenda Dardanisë së vjetër. Një prej tyre e cila quhej Krusha e Vogël, kur pata kaluar andej në vitin 1908, ishte formë në tranzicion, “krusha” duke qenë serbe dhe “e voglele” shqiptare - dardha e vogël. Sot me siguri është bërë “Krusha mala”- prapë serbe. Dardha e egër është e përhapur në këto vise, e fortë dhe e regjur, (ashpër), por me shije dardhe. Forma “e kultivuar” (shartuar) është shumë më e mirë. Dardha përdoret si shenjë qëndisëse tradicionale. Prej dy shembujve që jap (Fig. 3 dhe 4) “dardha e vogël” zakonisht qëndiset në skajet e këmishëve të grave malazeze. Modeli më i madh dhe i denjë është boshnjak dhe tregon frutin, degët dhe gjethet shumë qartë. Asnjëra nuk vjen saktësisht prej regjionit dardan. Ndërsa, ajo malazeze është diku afër. Ato tregojnë rëndësinë e dardhave në Ballkan. Emri i familjes së Papa Sixtus V. (1585-1590) ishte Peretti. Ai ishte fëmijë refugjati i ardhur prej “një vendi në Schiavonia” të quajtur Krushevo, të cilin e italianizuan dhe e adoptuan. Nuk kam mundur ta identifikoj atë Krushevo për të cilin bëhet fjalë.

Përshkrim i fig.3 dhe 4.

Fig.3 Krushka mala – dardha e vogël – punohet si skaj i këmishëve të grave malazeze me material të trashë pambuku në kryq të qepur në mëndafsh – të kuq, të gjelbër, të zi, të kaltër e duke u përsëritur me radhë. Është sa dy herë madhësia natyrore e dardhës.

Fig. 4 Shenja e dardhës e punuar në qepje të kryqtë me lesh llullaq në mëngët e këmishëve të grave; shenja përsëritet drejtpërdrejt dhe mbulon materialin që është pambuk i vrazhdë. Është e blerë në Jaica, Bosnjë (1906). Pak më e madhe se madhësia natyrore.

- Përgatiti dhe përktheu
-Arsim Canolli



Shkëmbimi studentor përmes Programit ERASMUS+

Shënime nga Bournemouth-i: Përvoja në programin Erasmus+

Unë jam **Era Brahimaj**, studente e vitit të tretë në Departamentin e Antropologjisë Kulturore.

Gjatë këtij viti pata mundësinë që përmes programit të shkëmbimit Erasmus+, të vijoj një semestër në Universitetin e Bournemouth-it në Angli. Dua të ndaj me ju pak nga kjo eksperiencë me ju. Gjatë këtij rrugëtimi mësova shumë, sidomos në aspektin profesional. Pashë nga afër një sistem krejt ndryshe të studimit dhe punës. Pashë se si është të jetosh në një shtet të Evropës Perëndimore si student. Kisha qasje në resurset që i ofron universiteti si: biblioteka online dhe bibliotekat fizike, të cilat kishin llojllojshmëri literature e materiale të nevojshme, klubet e ndryshme në kuadër të universitetit, hapësirat në kampus e disa elemente të tjera të cilat bënin më të lehtë procesin e të mësuarit. Përveç kësaj, u përballa me më shumë diversitet, kultura të ndryshme, dhe mendoj që kjo është shumë e nevojshme për një antropolog të ri. Një nga benefitet që nxorra nga ky udhëtim është se pata rastin të njohesh me profesionistë të ndryshëm të fushës, që në botën akademike është gjithmonë me interes.

Për shkak se aplikimin e bëra spontanisht, nuk isha e përgatitur për atë që më priste në Angli. Mu desh të pavarësohesha ndryshe nga që mendoja më parë dhe të ambientohesha në rrethana të reja, mund të them me plot vetëbesim që të gjitha sfidat e vogla përgjatë kësaj eksperience më kanë shërbyer mirë. Inkurajoj kolegët që nëse i'u ofrohet një mundësi e tillë ta shfrytëzojnë në të mirën e tyre.



Foto nga Era Brahimaj, "Bournemouth University", Angli

ALUMNI




Urtesë Zeneli

është studente e nivelit master në programin "CREOLE: Cultural Differences and Transnational Processes", Universiteti i Lubjanës, Slloveni. Urtesa ka mbaruar studimet në drejtimin Antropologji Kulturore (2017-2021) në Departamentin e Antropologjisë/Antropologji kulturore, Fakulteti Filozofik/UP. Studimet e saja MA financohen pjesërisht nga MKRS, për vazhdimin e studimeve antropologjike/ arkeologjike për studentët e dalluar.

Pas përfundimit të studimeve Bachelor në Universitetin e Prishtinës, e gjeta veten të mbushur me frymëzim dhe një motivim të thellë për të ndjekur hapin e radhës për karrierën time si antropologe. Etja ime për dije më shtyu të kërkoj pasurim të mëtejshëm akademik, andaj për këtë qëllim, mora vendimin për të vazhduar shkollimin në Universitetin e Lubjanës, institucion ky i cili ishte tashmë i njohur për reputacionin e tij në fushën e studimit të antropologjisë. Mirëpo, ajo që e bëri këtë rrugëtim arsimor edhe më të veçantë

ishte regjistrimi im në programin e përbashkët unik dhe novator të njohur si CREOLE, i cili ndryshe prej programeve të tjera, mban dallimin si programi i parë i përbashkët antropologjik në Evropë në partneritet me universitetet më prestigjioze evropiane. Teksa reflektoj mbi rrugëtimin tim akademik, më duhet të them se sa thellësisht ka ndikuar kjo përvojë tek unë në mënyra të shumanshme dhe, se si ka dhënë kritika thelbësore dhe vendimtare për rritjen time akademike. CREOLE ka dëshmuar të jetë një hapësirë transformuese, ku unë jo vetëm kam përmirësuar aftësitë e mia akademike, por edhe kam aplikuar zërin tim si antropologe në fushën e komunikimit vizual, veçanërisht përmes mediumit të filmit. Filmi etnografik është qëllimi im kryesor në studimet e mia dhe synoj të thellohem në këtë formë të prodhimit të njohurive antropologjike dhe të eksploroj potencialin e saj për të hedhur dritë mbi praktikën e pasura dhe të ndryshme kulturore dhe sociale të Kosovës. Gjithashtu, gjatë pjesëmarrjes sime në programin CREOLE, kam pasur privilegjin të përfshihem në



programin special intensiv njëjavor të mbajtur në Bern të Zvicrës, ku pata nderin e veçantë të prezantoj idetë rreth temës sime të magistraturës dhe më mundësoi të diskutoja dhe shkëmbeja metodologji të ndryshme për dokumentimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë ndërmjet filmit etnografik, duke përfshirë qasjet inovative siç janë përvojat shqisore përmes dokumentacionit audiovizual. Për më tepër, gjatë këtij programi intensiv, pata mundësinë dhe kënaqësinë të angazhohesha me shumë student të tjerë me prejardhje të ndryshme kulturore, ku së bashku diskutuam se si filmi etnografik zotëron potencialin për të kapërcyer hendekun midis kërkimit akademik dhe mirëkuptimit publik. Mbi të gjitha, realizon këtë duke ofruar një vështrim intim dhe zhytës në jetën e njerëzve si dhe mund të shërbejë si një mjet i fuqishëm për ruajtjen dhe ndarjen e trashëgimisë kulturore duke promovuar shkëmbim mes kulturave të ndryshme. Andaj dhe vizioni im për studimet e mia të ardhshme mbetet i rrënjësor në këto shtylla. Kosova është një vatrë e diversitetit kulturor

dhe dinamikave sociale, historike dhe bashkëkohore, që kërkon eksplorim dhe dokumentacion mirëfilltë. Aspirata ime është që t'i jap zë Kosovës dhe të përdor filmin etnografik si një platformë për të ofruar hapësirë për këto biseda jetike, andaj roli im në këtë kuadër të punës është të shfrytëzoj filmin etnografik si një mjet jo vetëm për të avancuar kërkimin akademik, por edhe për të rritur ndërgjegjësimin për diversitetin kulturor, çështjet sociale dhe të drejtat e njeriut përbrenda kontekstit kulturor. Së fundi, ky vizion i punës sime në të ardhmen është një angazhim për të dokumentuar dhe ndarë historitë e shumëanshme që burojnë nga ky rajon i jashtëzakonshëm dhe, duke e bërë këtë, gjithashtu promovon hapësirë për dialog ndërkulturor.



Tringa Berbatovci

është studente e vitit të dytë- niveli master në programin "Arkeologji dhe Histori", në Departamentin e Shkencave Antike në École Normale Supérieure- PSL në Paris (Francë). Tringa ka mbaruar studimet në programin Arkeologji (2018-2021) në Departamentin e Antropologjisë/Arkeologji, Fakulteti Filozofik/UP. Ajo është bursiste e Qeverisë Franceze dhe falë bashkëpunimit në mes të École Normale Supérieure-PSL, Ambasadës së Francës në Kosovë, Universitetit të Prishtinës si dhe Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në Kosovë, është bërë i mundur vazhdimi i studimeve në fushën e arkeologjisë për studentët e dalluar.

Ngritja e kapaciteteve të mia profesionale në fushën e arkeologjisë ka qenë dhe mbetet një ndër synimet kryesore, e që padyshim kënaqësia shtohet kur këtë arritje ta bëj në Paris. Një vend ky, ku si një udhëkryq shkencash gërshetohen: historia, arti, arkitektura, arkeologjia, e shumë shkencë të tjera për cilat njerëzit kanë interesa të pashuar. Ëndrrën e fëmijërisë po e jetoj tani, duke qenë studente e një prej universiteteve më prestigjioze në botë. Në ambientet e të cilat ligjërojnë mendjet më të ndritura të planetit, ky universitet, dikur fole e disa prej laureatëve të çmimit Nobel si: Henri Bergson, Romain Rolland, Jean-Paul Sartre, Louis Pasteur, etj. Misioni i së cilës është "Arti i të mësuarit nga profesionistët- L'Art de l'Education." Në

ambientet e këtij universiteti, ndjeva që e kaluara takon të tashmen në çdo cep të saj dhe, kjo jo vetëm përmes imagjinatës, por duke qenë aty përballë, një me të. E them këtë sepse metodologjia e studimeve në këtë shkollë prestigjioze të mundëson në formimin tënd si arkeolog në të ardhmen dhe shtrirjen e diapazonit të njohurive, duke pasur mundësi e qasje në laborator (AOROC), qasja në laboratorin C2RMF (si i vetmi i tillë në botë) që fshihet poshtë në bodrumet e muzeun më të madh në botë, në Luvër (Musée du Louvre). Aty ku përdoren teknikat më inovative kimike dhe fizike për analizim, trajtim dhe datim të artefakteve. Dikur ky vend ka qenë i njohur vetëm nga leximet e mia, kurse tani, më mundësohet vetë pjesëmarrja në konferenca shkencore, në ekspedita arkeologjike si në Pompei -Itali, Egjipt, etj., ekspedita që kalojnë edhe kontinentin evropian, si në Azi e Afrikë, e po ashtu edhe përdorimi i softuerëve të fundit në arkeologji. Ajo që mbetet e vazhdon të jetë impresionuese për mua është bujaria dhe zemërmirësia që kanë francezët. Në Paris rastisa të takoj njerëz të mrekullueshëm, studentë nga çdo regjion i Francës, por edhe nga e gjithë bota, me të cilët çdo ditë shkëmbejmë pjesë nga kulturat tona. Përmes takimeve, ne arrijmë të kuptojmë se sa të ngjashëm e të ndryshëm jemi, por, që në fund, gjithmonë arrijmë të takohemi në një pikë të përbashkët, e që padyshim si asnjë tjetër është pasioni për arkeologjinë.



E cilësuar si një nga gjuhët më romantike e poetike në botë, dhe e dyta në botë për nga përdorimi, gjuha frënge është një tjetër element shumë i rëndësishëm i studimeve të mia në Francë, sepse të mundëson një qasje komunikuese me të tjerët dhe natyrisht shpërfaqë diapazon të dijes.

Gjatë kohës së studimeve të mia në nivelin Bachelor, ajo që ka zgjuar shumë kureshtje tek unë, meqenëse kam studiuar edhe arkitekturë, është ndërthurja e arkeologjisë me arkitekturën. Duke parë dhe vështruar strukturat arkitektonike, mënyra e organizimit të qyteteve, teknikat e ndërtimit të tyre, përdorimi i materialeve, por duke trajtuar edhe aspektin social e shpirtëror dhe si kanë ndikuar ato për qytetërimet e lashta, brenda së cilave është mundësuar jeta e dardanëve tanë të lashtë. Shpeshherë të vendosur në toka të rraëfshta, e shpeshherë mbi kodra të larta, duke u mbrojtur, e duke luftuar, ky popull i lashtë arriti të krijonte art e arkitekturë. Sot nëntoka jonë mbetet një burim i pashterueshëm arkeologjik, e pasur nga ana materiale e shpirtërore.

Mbështetja dhe bashkëpunimi nga ana e profesionistëve gjithmonë mbetet një faktor shumë i rëndësishëm drejt suksesit dhe rrugëtimit profesional të çdo studenti. Natyrisht kjo mbështetje për përgatitjen time profesionale ishte padyshim nga profesorët e Departamentit të Antropologjisë, të cilëve u jam mirënjohëse gjithmonë, veçanërisht Profesorit Arben Hajdari dhe Asistentit Ilir Culaj, të cilët edhe pas mbarimit të studimeve vazhdojnë të qëndrojnë mbrapa meje gjatë çdo hapi të këtij rrugëtimi akademik. Departamenti i Antropologjisë, mundëson pa asnjë dyshim përgatitje të studentëve me kuadro cilësore për vazhdimin e studimeve jashtë vendit. Studentët e pasionuar pas trashëgimisë kulturore e veçanërisht arkeologjisë duhet të punojnë fort për të realizuar dhe mos hequr dorë nga ëndrrat e tyre, sepse me punë çdo sukses është drejt rrugës së tyre të dijes.



In Memoriam

Më 17 Janar 2023 na la Edi Shukriu,
arkeologia e parë shqiptare në Kosovë.

Prof. Edi Shukriu do të mbahet mend për kontributin e
saj të jashtëzakonshëm në formimin e brezave të rinj
të arkeologëve, si dhe për angazhimin e palodhshëm
në zhvillimin e dijes arkeologjike në vendin tonë.



Edi Shukriu
1950 – 2023

Sonte zemrat tona kujtojnë

“Ikni,

Sonte zemra ime feston ...

Zhdukuni nga oda ime

Se sonte shpirti do të ma dejë arsye

[...]

Dua të loz,

e lirë

e dëlirë,

të loz në afshin e zemrës

Ju fal qaforen e dhuruar nga ju,

Merreni dhe vallen e rrejtshme

Dhe ikni se sonte kam festë...

Vasha juaj ngritet mbi hijet e kullave

Me shikimin që udhëton, të duket, në asgjë.”

Kështu nisë poezia e parë e Edi Shukriut, asokohe 22 vjeçare, vashë nga Prizreni i kalasë, i Shën Premtes, Hasit të Bogdanit, Drinit plak, Lidhjes e shadërvanit freskues, poezia e bijës së Muhamed Shukriut dhe Margarita Mjedës. Kjo është poezia e parë nga vepra me të njëjtin titull, “Sonte zemra ime feston”, e botuar më 1972, një vinjetë poetike ku shpërfaqet revolta dhe entuziazmi i një zonje të re shqiptare, që synon të vazhdojë rrugën e saj, si e lirë dhe e pavarur, kundruall ambientit përreth. Me këtë pasion, që del edhe nga poezitë e saj të para, Edi Shukriu merr botën në sy drejt të mistershmes, drejt të palëpalshmes së shpirtërores së njeriut të tokës së saj. Në udhëtimin e saj, gjen labirinte, perëndi, mite e legjenda, gjytete e gradina, zjarrniqe e murana; atje gjen amfora e mbishkrime, art në shkëmb e art në mozaiqe; rrugës gjen edhe shkrime të vjetra, dialogje të hershme mbi vendin e saj, vendin e dardhëve, Dardaninë antike. Pikërisht këtë tokë, në një anë i studioi si studiuese, në mënyrë shkencore, e në anën tjetër, e poetizoi për shpirtin e saj dhe për kënaqësinë tonë si lexues, për të na inspiruar përherë.

Poezia dhe arkeologjia

Poezia dhe arkeologjia kanë diçka të përbashkët: ato gjakojnë të mistershmen. Poezia krijon metaforë për të mistershmen, për atë që e ndiejmë, por që vështirë

mund ta shpjegojmë. Arkeologjia synon njohjen e të mistershmes e të kahmotshmes të trashëguar nga stërgjyshërit tanë, prej hominidëve të parë e deri të ne. Por, të dyja, poezia dhe arkeologjia, rrëfejnë për gjërat që ruajmë brenda: poezia për ato që ruajmë në gji të shpirtit, arkeologjia për ato që ruajmë në gji të tokës.

Te poezia e Edit, vërehet gjithandej një poetikë e frymëzuar nga arkeologjia, apo një arkeopoetikë, nëse duam të krijojmë figurë-model të kësaj poetike. Ja një poezi, ku vërehet arkeopoetika e veçantë e poetes-arkeologe.

Erdhi i pari

La themelet e bazilikave

Vuri pingul në zemër

Mbishkrime varri –

Shkronja të tjera,

Fryma jonë

Erdhi i dyti,

Ngriti kisha mbi themele

I huajti duart tona

Ngriti lavdi për vete

Erdhi i treti

Prishi kambanaret

Dhe përsëri therri qiellin

Mbi livadhet e gjelbërta

Tumat

[Poezia “Tumat”, nga përmbledhja e vitit 1979
“Gjakimi”]

Edhe te përmbledhja “Syri i natës” (1986) dhe te përmbledhja poetike “Nënqielli”(1990), ku figurativizohet Prizreni dhe areali kulturor përreth tij, Hasi dhe Sharri, me metafora, sinekdota, alegori e plot figura e shenja, simbole e mite, vërehet arkeopoetika e saj, ku përmes poezisë shprehet imagjinata arkeologjike.

Gjakimi i poetes dhe arkeologes drejt njohjes së civilizimit të lashtë të tokës së saj do të vazhdojë. Edi

Shukriu mbaron studimet shkollore deri në doktoratë në Prishtinë e Beograd. Pas studimeve, ajo kthehet dhe punon në Muze të Kosovës, pastaj në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku fillon të ligjërojë historinë antike e arkeologjinë, prej vitit 1979 deri më 2020. Ajo bëhet sinonim i gruas arkeologe, jo lehtë në kohën e saj - ajo bëhet edhe simbol i studimeve arkeologjike mbi Dardaninë, apo Kosovën antike, siç e quajti në një ndër librat e saj, me fokus te hyjnesha dardane, kultet, monumentet epigrafike, e me radhë. Edi hyri në labirintin e saj arkeologjik, gjeti e studioi labirinte të kësaj toke, hapi rrugën për studentë të saj, bashkëpunoi me kolegë nga universitete e të ndryshme ndërkombëtare, kumtoi për arkeologjinë kosovare në konferenca e simpoziume, u përkthye në gjuhë të huaja e dha mësim në Fakultetin Filozofik për 41 vite me radhë, edhe në kohë të vështira për të dhe Kosovën, pandërprerë e me plot vullnet.

Studentët e saj u dashuruan me gërmimet e studimet arkeologjike dhe disa prej tyre vazhduan në universitete botërore, disa u kthyen dhe vazhdojnë gërmimet e kërkimet, por askush prej tyre nuk e harron emrin e Edi Shukriut, arkeologes të Kosovës, që grishi studentët në botën e çudirave të lashtësisë, duke i drejtuar që ta gjakojnë atë. Veprat e saj arkeologjike, puna e saj me studentë, ligjërata dhe projektet e realizuara, shkollat verore dhe konferencat, do të mbeten përherë në kujtesën institucionale e personale të studentëve e miqve të saj. Puna e saj në hapjen e degës së arkeologjisë, në Departamentin e Antropologjisë, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, është themeltare dhe do të vlerësohet përherë.

Në veprën e punën e përgjithshme të profesoreshës, përthyhen shumë dimensione. Ndër to edhe politika. Por, politika, jo si gjendje imanente e vokacionit ditor, por si vullnet në një kohë esenciale për të refuzuar dhunën e Serbisë dhe si dëshirë e nevojë imediate për të ndërtuar institucionet kulturore të shtetit të Kosovës, pas luftës. Emri i profesoreshës Edi Shukriu do të jetë gjithmonë i lidhur edhe me jetën publike, shërbimin publik ndaj shtetit të Kosovës. Gjatë viteve '90 ajo qe pjesë e qendrestarëve paqësorë të Kosovës, iu bashkua lidhjes që kishin krijuar shkrimtarët, poetët, historianët, arkeologët, sociologët, etnologët, mjekët, gazetarët e të gjithë të tjerët, në krye me studiuesin e letërsisë Ibrahim Rugova, më vonë presidenti historik i Republikës së Kosovës. Pas luftës, ajo udhëhoqi me Departamentin e Kulturës, që sot është Ministria e Kulturës, me Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe themeloi e drejtoi institucione të tjera të

trashëgimisë kulturore.

Një pusullë nga kujtesa personale

Profesoreshën Edi Shukriu e kam njohur nga librat dhe nga kolegjaliteti në Departament. Por, profesoreshën e kam njohur edhe më herët, që nga fëmijëri, nga një rast kur isha nxënës i fillores, kur në një organizim të shkollave fillore të Kosovës më 1991, pata marrë pjesë në një turne njëmuor në Austri, së bashku me 100 nxënës të tjerë nga gjithë Kosova. Nën drejtim e profesoreshës, patëm përgatitur drama, recitale e aktivitete të tjera artistike e kulturore, për t'ia paraqitur austriakëve e të tjerëve gjendjen e Kosovës së atëherëshme, për një muaj rresht në Vjenë, Grac, e qytete të tjera. Ende më kujtohet refreni kryesor i këngës, që ishte një himn për Republikën e Kosovës, që Edi na pati mësuar:

Ti Kosovë moj bijë dardane

Je e mbesa e Ilirisë

Se në këto troje je sovrane

Je tribunë e demokracisë...

Prej atëherë, fjala Dardani, më është pleksur dhe tani e përdor goxha shpesh. Madje kolegët, në humor, ma kujtojnë shpesh këtë obsesion tim me fjalën Dardani. Fajin e mirë për këtë e ka pasur edhe profesoresha Edi Shukriu!

Edi Shukriu ka lënë një trashëgimi të begatë ligjëruese në Universitetin e Prishtinës, trashëgimi të cilën e ka krijuar me punë dhe e ka lënë me nder, në duart e nderin e studentëve e kolegëve të saj. Por, puna e vepra e saj do të jenë corpus callosum në arkeologjinë e Kosovës. Puna e saj na nderon të gjithëve, na inspiron e na jep guxim për me vazhdue gjakimin drejt zemrës së tokë sonë!

Sot, Edi Shukriu kaloi në amshim. Sonte shpirti i saj pushon, por zemra e saj është e mishëruar në veprën e saj, në trashëgiminë e saj të denjë në kulturën e Kosovës. Sot jemi të pikëlluar të gjithë, kolegët e studentët e saj. Por, sonte e prore, zemrat tona do kujtojnë Edi Shukriun e do ta festojnë veprën e saj.

Pushoftë e qetë në Kosovën e saj të dashur, Dardaninë antike!

17.01.2023

- Arsim Canolli





“Kujtesa e Trepçës”


prgt: Arsim Canolli

Më 19 Prill, 2022 u prezantuan botimet me 10 vëllime të librit “Kujtesa e Trepçës: rrëfime të 100 punëtorëve të Trepçës”, të cilat përmbajnë 100 transkriptime të 100 videointervistave me ish-punëtorë, mbi 65 vjeçar, të kombinatit Trepça. Kjo përmbledhje u realizua nga një punë një vjeçare me grupin punëtor nga Mitrovica, kolegëve të organizatës 7 Arte, Lulëzim Hotit, Diellza Jëlliçit, Rinor Kurshumliut, Egzona Rexhës, Ardiana Koliqit, Samir Kurtit, dhe 5 hulumtueseve të reja nga Departamenti i Antropologjisë dhe Sociologjisë në Universitetin e Prishtinës: Greta Avdyllit, Valentina Krasniqit, Miridona Sylës, Ardita Aliut dhe Ridona Berishës.

Falë këtyre hulumtuesve, nën koordinimin e mentorit të projektit Arsim Canollit, u arrit të dokumentohen 100 rrëfime plot histori, ngjarje e përjetime të minatorëve të Trepçës. Këto rrëfime do bëhen evidenca esenciale për studime të mëtutjeshme dhe material burimor për Muzeun e Trepçës, që do krijohet në të ardhmen. Kjo kujtesë është fryt i rrëfimeve të sinqerta, autentike dhe plot pasion të 100 punëtorëve të minierës së Trepçës. “Kujtesa e Trepçës” jep rrëfime me plot emocione, dhimbje, vuajtje dhe vetëbesim. Ato janë një testament shtesë për një prej gjigantëve më të mëdhenj industrial në botë, gjatë shekullit të kaluar. Rrëfimet e përjetimeve të tyre shkojnë pas nga vitet e ‘50 e deri më sot. Aty është rrëfyer për përvojat që kanë treguar prindër e gjyshër, që kanë punuar në Trepçë, për rrëfimet për grevat e burgosjet, për vullnetin e qëndrueshmërinë, për vazhdimin e rezistencës kundër regjimit të dhunshëm të Serbisë gjatë viteve ‘90, për jetën para, gjatë, e pas luftës, të gjitha të lidhur më Trepçën.

Në këto vëllime, dokumentohen transformimet politike nëpër të cilat ka kaluar kombinati Trepça. Rrëfëhet historia e zbulimit të Trepçës, dokumentohet mbi prodhimet e Trepçës e organizatave të saj, tonelatat e eksportimeve nëpër botë. Shumëçka u tregua, për tu kujtuar prapë grevat e minatorëve në vitin 1989, burgosjet, malltretimet e dënimet, marshin në Prishtinë të nëntorit të vitit 1988, pajtimin e 3 gjaqeve në minierë gjatë grevës para se të fillonte aksioni në krye me studentët e Anton Çettën, aksionin “Familja ndihmon Familjen”, njerëzit që ndihmuan, pleq e plaka, studentë të rinjtë, të gjithë me sy e vesh e zemër kah Trepça dhe punëtorët e saj.

- Arsim Canolli



Përkthim:


“Shkatërrimi i kujtesës: Arkitektura në luftë”

nga Robert Bevan, përkthyer nga Florina Jerliu

“Shkatërrimi i kujtesës - arkitektura në luftë” i autorit Robert Bevan është një libër që, përmes shembujve të shumtë emblematic e simbolik të konflikteve e luftërave në botë e përgjatë historisë, hap diskutimin rreth rëndësisë që ka arkitektura, jo vetëm në mirëqenien materiale të një populli, por në kujtesën e tij, në ndjenjën e përkatësisë që e jep ajo, në artikullimin kolektiv të ekzistencës dhe vazhdimësisë historike, sociale, politike e kulturore.

Siç kuptohet nga leximi i këtij libri, shkatërrimi i arkitekturës në luftë është krimi më i përhapur i epokave. Shkatërrimi i saj është beteja për zhbërjen e një populli; është indikator për gjenocidin në ardhje ose në bërje. Robert Bevan e zhvillon këtë argument ndërsa vëren se, edhe shkatërrimi i trashëgimisë arkitektuale joserbe të Kosovës ishte element i planifikuar dhe metodik i spastrimit etnik, që si i tillë synon çrrënjosjen e pranisë historike dhe identitetit kolektiv të popullit shqiptar.

- Florina Jerliu



“Dromca etnografike”

nga Zanita Halimi

“Libri “Copëza Etnografike” nga Zanita Halimi ofron një lëndë monografike për fushën e gjerë të antropologjisë kulturore. Aty përfshihen tema e problematika të ndryshme të cilat me kujdes konceptohen e vendosen si punime studimore ose si ese të shkurtëra, të veçanta, esencialisht të lidhura mirë ndërmjet vete. Libri bartë lexuesin nga një tematikë në tjetrën, duke sajuar kështu një ndjenjë të kuptimeve kulturore si një e të pa ndarë.

Është me interes të theksohet se autorja Halimi shqyrton, shpjegon dhe organizon çështjet duke u mbështetur në metodën e hulumtimit etnografik, të vëzhgimit ose observimit pjesëmarrës, të krahasimit dhe të intervistimit. Kjo mënyrë e punës i mundëson autores të ofrojë të dhëna të reja e të nxjerrë konkludime të qëndrueshme profesionale dhe shkencore.

Libri reflekton çështje të reja dhe të vjetra, të traditës e të modernitetit, të cilat lidhen e ndërthuren me sukses në një fushë të përgjithshme shkencore të quajtur antropologji kulturore. Punimi mbi dasmën, psh., shpërfaqë dukuri e praktika që zhvillohen në shtëpi të vajzës ose të dhëndrit, si traditë, por edhe në restorante si modernitet, si dukuri të reja. Kështu, nga filozofia apo mendësia zakonore arrihet në transformime e globalizime, duke qenë se në njërin anë

vendosen prezantimet dokësore dhe në anën tjetër ato të teorive antropologjike, si të Stuard Hall e të tjera. Kur flet për familjen, autorja nuk harron ta shohë zhvillimin e saj që nga e kaluara, por gjithsesi shtron edhe tabu-temat si dukuri që shënueshëm vërehen e diskutohen në modernitet.

Është për t'u potencuar punimi dhe shkrimi frymëzues mbi fotografinë familjare, si pasqyrim i konteksteve shoqërore dhe si inventar kulturor, jo vetëm i kulturës materiale të dukshme, por edhe i marrëdhënieve njerëzore, si të padukshme. Në rastin tjetër, fotografia trajtohet si mjet për materializimin e kujtesës, mjet për prezantime të ndryshme dhe si mjet i veçantë për rolin vizuel dokumentues të realitetit në antropologjinë kulturore. Temat e këtylla janë plotësisht të reja në Kosovë. Gjithashtu, duhet veçuar punimin për kulturën materiale të memorialeve të ndërtuar në hapësira publike, ku mjeshtërisht diskutohen lidhjet e rëndësishme të traditës shqiptare në mendësi dhe në pamjet vizive të realizuara në beton e në mermer. Dallohen llojet e memorialeve buzë rrugës, si më të thjeshta dhe memorialet e luftës, që zakonisht janë më komplekse dhe domosdoshmërisht të dekoruara me simbole kombëtare.

Nga shkrimet të cilat zgjojnë emocione, duhet përmendur rastin e flamurit “Autochtonus”, si një inovacion individual për identifikimin kombëtar në një lojë futbollit, të zhvilluar në Beograd. Autorja arrin që me hulumtime në terren, me intervista të veçanta për rastin “Autochtonus” e të tjera, të konkludojë se ashtu si e thotë teoria, simboli është një shenjë arbitrare ose konvencionale, ose një veprim që sugjeron diçka tjetër nga ajo që tregohet si simbol vizual në një rast konkret.

Kur flitet për mikpritjen dhe turizmin, autorja shkathtësisht pasqyron se si dialogohet tradita në funksion të turizmit. Në këtë rast shqyrtohen shembuj të mikpritjes sipas të drejtës dokësore, pa lënë anash dukuritë dhe lidhjet e raportet e ndërsjella të fenomeneve të modernitetit, si mikpritja dhe hapësira publike, mikpritja dhe rituali e të ngjashme.

Ritualet pasqyrohen si praktika të motmotit me poesis dhe praxis të pasur të lashtësisë, por edhe të kohës së modernitetit dhe, në nanën tjetër si rituale të mediave, ose si ritualizim i mediave.

Së fundi, duke lënë lexuesit ta shijojnë çdo shkrim të këtij botimi, dëshiroj të theksoj se librit ia shtojnë vlerën edhe fotografitë e bëra drejtpërdrejtë gjatë hulumtimeve vetanake të autores në krahina të ndryshme gjeo-etnografike. Libri ka vlera shkencore dhe është kontribut i dobishëm për antropologjinë kulturore, veçanërisht për studentët të studimeve etnologjike, përkatësisht antropologjike.”

- Drita Statovci Halimi



“Zejet tradicionale të Kosovës”

nga Valon Shkodra

Katalogu “Zejet tradicionale të Kosovës”, është vazhdimësi e një pune të gjatë hulumtuese në terren për njohjen, evidentimin dhe fotografimin e zejeve tradicionale që ushtrohen në vendin tonë. Hulumtimi jonë kërkimor për këtë katalog është fokusuar kryesisht në qytetet e Kosovës, pra, është një studim i etnografisë urbane. Ideja na lindi pikërisht nga terreni dhe, në terren ku kemi bërë përpjekje t'i nxjerrim në pah vlerat artizanale të secilës komunë, gjithnjë duke pasur parasysh një përfshirje sa më të madhe të qendrave tona kryesore. Qytetet, zejet e të cilëve janë përfshirë në këtë katalog janë: Prishtina, Prizreni, Gjakova, Mitrovica, Vushtrria, Gjiçani, Ferizaj, Podujeva, Kaçaniku, Klina, Kamenica, Skenderaj dhe Dragashi. Në katalog janë të prezantuara gjithsej 260 fotografi të ndryshme të zejeve të sipërpërmendura dhe lagjeve të qyteteve, që dikur kanë qenë të njohura për qytetarët, tregtarët dhe zejtarët brenda e jashtë vendit. Ndonëse zhvillimet e trendëve të reja, fatkeqësisht favorizojnë pakësimin dita-ditës të zejeve tradicionale, megjithatë hulumtimet tona kanë rezultuar me evidencimin e gjashtëdhjetë lloje të zejeve tradicionale që vazhdojnë veprimtarinë e tyre edhe sot e kësaj dite dhe, të bashkëbisedojmë me 100 subjekte, shumica sosh zejtarë ose ish-zejtarë. Zejet e evidentuara dhe të prezantuara në këtë katalog janë: plisaxhinjtë, kapelapunesit, argjendarët, orëtarët, poçarët, fotografët, çantaxhinjtë, rrobaqepësit, endja, qepja, tekstili, bojaxhinjtë, konopxhinjtë, lulaxhinjtë, farmacistët popullorë, sheqerxhinjtë, shportaxhinjtë, hasraxhinjtë, çadraxhinjtë, armëtarët, kazanxhinjtë, tabakxhinjtë, papuçexhinjtë, këpucëtarët, nallexhinjtë, pajtonxhinjtë, berberxhinjtë, qebaptorexhinjtë, briskaxhinjtë, leblebixhinjtë, faraxhinjtë, kafexhinjtë, gjellëbërësit, bozaxhinjtë, parfumeri, farkëtar, drugdhendësit, artizanet e qilimave, artizanet e dollamave, taksistët, saraçët, jorganxhinjtë, çibukçinjët, bakërçinjët, kazanxhinjtë, poçarët, taxhapunuesit, lëkurërexhësit, lustraxhinjtë, ëmbëltorxhinjtë, furrarët, gjellëtoret, byrektoret, duhanpunuesit, xhamaprërësit, mullinxhinjtë, teneqexhinjtë, çajtoret, mjeshtëria në instrumentet muzikore, mjeshtëria artistike në gur, zhgunaxhinjtë, gajtanaxhinjtë, kasapët, nallbanët dhe qerre punuesit. Katalogu ka gjithsej 189 faqe.

- Valon Shkodra



“Kujtesë në Gurë”

nga Kaltrina Igrishta, Lekë Shala,
Anduena Halilaj

“Kullat flasin, vetëm duhet ti kuptojmë” - Michael L. Galatay

“Kujtesë në Gurë: gdhendja e simboleve në Kulla” pikëton studimin etnografik dhe arkeologjik në mënyrë që të evidentojë dhe dokumentojë gdhendjen e simboleve në gurët e shtëpive tradicionale, dhe hapësirave të tjera të përdorimit shtëpiak në territorin e Republikës së Kosovës. Me njohjen e simboleve u pasurua shpjegimi mbi organizimin shoqëror, sistemin e dijeve, besimeve të shqiptarëve si dhe ndërlidhjet e tyre me mjedisin.

Kaltrina Igrishta, Lekë Shala dhe Anduena Halilaj përmes projektit Kujtesë në Gurë kanë punuar për të sjellë një produkt shkencorë mbi simbolet në Kulla. Ideja për këtë punë ka ardhë nga mungesa e dokumentimeve të një periudhe shumë të rëndësishme të Kosovës, e specifikisht periudhë ku e kemi një lulëzim të ngritjes së Kullave. Simbolet janë zemra e shtëpisë, e për ta kuptuar shoqërinë ia mësymë dokumentimit dhe interpretimit të tyre.

Lidhjen mes së tashmes dhe të kaluarës e gërmuam në libra etnografik, historik e gjeografik. Vegzën e kishim në dorë, interpretimit të historisë së Kullave iu bë një përditësim. Të dhënat statistikore që nxorëm në teren, historitë orale e ato të shkruara u përputhën dhe nuk u përputhën në shumë

pika. Ndërsa, ne të gjitha të dhënat i shoshitëm dhe nxorëm një përmbledhje për rëndësinë e simboleve në kulla për banorët e shtëpisë e për shoqërinë. Kjo punë u mentorua nga Erëmirë Krasniqi, ndërsa shumë njerëz kontribuuan e i dhanë kuptim këtij libri: Florian Cousseau, Marie Besse, Michael L. Galatay, Eliza Shala, Bardhyl Dobroshti, Elisa Shkurtaj, Erina Baçi, Rrona Abrashi etj. dhe na rikujtuan që puna në grup është çelësi i një studimi të mirëbërë!

Në gjithë territorin e Kosovës janë ngritur Kulla dhe u janë gdhendur simbole. Simbolet gjerësisht të përhapura, punoheshin përmes teknikave të ndryshme, si gdhendje, relief, skulpturë, pikturë apo edhe si bashkëdyzim. Simbolika e tyre shprehet përmes figuracionit të pasur që shpeshherë shpërfaqte besëtytnitë, besimet dhe aspiratat e pronarëve të shtëpive. Elementet e gdhendura në gurë ndërthuren ngushtë me ornamentikën në veshje, objekte prej druri, hapësira publike, objekte fetare, në gurët e varreve, në vezë të ngjyrosura rituale, në tatuazhe dhe të tjera. Ato janë pjesë e një praktike kulturore të shtrirë edhe jashtë territorit të Kosovës, andaj, ky studim është copëz plotësuese e një dimensionit më të gjerë të albanologjisë që përmbushet përmes studimeve krahasuese. Përnjohja e tërësishme e vendit, vë në pah ngjashmëritë, dallimet, veçantitë dhe parapëlqimet nën-rajonale sa i përket simboleve.

Libri përbëhet nga dy pjesë kryesore. Pjesa e parë prezanton tekstualisht korpusin e simboleve në kulla (shek. XVIII-XX), përmes dokumentimit statistikor, shtrirjes hapësinore, dhe synon ta shpjegojë praktikën dhe kuptimin e simboleve të bazuara në histori gojore, dhe nga studimet e mëparshme. Pjesa e dytë paraqet dokumentimin pamor të simboleve dhe kullave, si dhe pamje të mbledhura gjatë punës në terren. Tërësia e pjesëve do i krijojë hapësirë studiuesëve të gjurmojnë të njëjtin fenomen përmes këndeve të ndryshme ndërdisiplinore.

Ky libër është mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe UNDP.

- Kaltrina Igrishta, Anduena Halilaj, Lekë Shala



Foto nga terreni “Kujtesë në Gurë”

Seminari i Antropologjisë

1.

Prof. Asoc. Dr. Mikaela Minga, etnomuzikologe, IAKSA/ASA, Tiranë

“Auraliteti dhe etnomuzikologjia në Shqipëri: Regjistrimet zanore të Elbasanit si rast studimi”

(më 26 tetor 2023, ora 16.00, salla 127)



2.

Prof. Dr. Regina Bendix, antropologe, University of Göttingen, Gjermani

“Intangible Heritage: Knowledge, Experience and Unequal Value”

(më 30 nëntor 2023, ora 16.00, salla 127)

3.

Prof. Dr. Adam Drazin, antropolog, UCL, Londër

“Extreme Fashion: The Sensuality of Digital Experiences and Materials”

(më 14 dhjetor 2023, ora 16.00, salla 127)

4.

Prof. Asoc. Dr. Florina Jerliu, arkitekte, Fakulteti i Arkitekturës/UP

“Vazhdimësia dhe Ndryshimi” si përgjigje ndaj sfidave të “Konservimit dhe Menaxhimit”

(më 11 janar 2023, ora 16.00, salla 127)

5.

Prof. Ass. Dr. Zanita Halimi, antropologe, Departamenti i Antropologjisë/UP

“Ruajtja e tashëgimisë kulturore përmes fotografisë familjare”

(më 29 shkurt 2023, ora 16.00, salla 127)

6.

Prof. Dr. Cord Pagenstecher, historian, Freie Universität Berlin, Gjermani

“Oral-History.Digital: A platform for the archival, curation and presentation of biographical interviews”

(më 28 mars 2023, ora 16.00, salla 127)



7.

Prof. Ass. Dr. Angela Labrador, John Hopkins University, SHBA

“Leveraging Anthropology: Shaping the Future of Cultural Heritage Education”

(më 25 prill 2023, ora 16.00, salla 127)

8.


Dr. Prentim Alaj, arkeolog, Instituti Arkeologjik i Kosovës, Prishtinë

“Dardania (Kosova) gjatë periudhës së hekurit: karakteristikat e vendbanimeve, praktikat funerale dhe kultura materiale”

(më 23 maj 2023, ora 16.00, salla 127)

Falënderime

*Faleminderit profesorëve të Departamentit,
kolegëve tanë dhe të gjithë atyre që kontribuuan
në realizimin e numrit të pestë të Vjetarit AA.*



Ju jemi mirënjohës!

Enis Bytyqi dhe Tringa Sefedini



Tetor 2023/ Nr.5